



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 62/2021 Regjistri (JR)
Datë 01.11.2021

Nr. 39 i vendimit
Datë 25.09.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi më datë 25.09.2023, ditën e hënë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me sekretare gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Rezarta Balliu, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKT: Shqyrtimi i vendimit nr. 418, datë 09.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 6 e vijues të Konventës Evropiane të të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut; Nenet 179/b/2, 5, 7 dhe C, Ç, D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, me ndryshimet e ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; Nenet 2, 3/5, 4, 6, 22, 23, 27, 30, 32, 33/4, 44, 45, 47, 52, 55, 57, 58/1, 59 e në vijim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Nenet 5, 6, 13, 14, 42, 45, 47, 78, 87, 50, 84 e në vijim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Nenet 44 e në

vijim të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Nenet 1, 3, 5, 7 e në vijim të ligjit nr. 96/2016.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Rezarta Balliu, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 418, datë 09.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Rezarta Balliu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ajo iu nënshtrua rivlerësimit *ex officio* me shortin e hedhur nga Komisioni më datë 12.11.2019.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) mbështetur në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹ duke konkluduar se: *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite (në vitin 2007); ka kryer deklaram të rremë; bashkëshorti i subjekti ka ushtruar funksionin në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Komisioni, me vendimin nr. 418, datë 09.07.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin konkludoi se:
 - i. Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.
 - ii. Ka kryer veprime fiktive dhe deklaram të rremë.

¹Shkresë nr. {***} prot., datë 12.02.2018.

- iii. Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve në përputhje me germën “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
- iv. Ka deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë në përputhje me pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Rezarta Balliu

- 5. Kundër vendimit nr. 418, datë 09.07.2021, të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit duke kërkuar prishjen e vendimit të Komisionit.

Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale, të cilat në mënyrë të përmbledhur lidhen për cenim të procesit të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), nenit 42, pika 2 dhe nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, për sa i përket: formimit të trupit gjykues të Komisionit dhe të drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj; rrëzimit të disa kërkesave të saj për marrjen e provave; vlerësimin e saj bazuar në të tria kriteret e vlerësimit; kalimin e një barre prove tej mundësive objektive për paraqitjen e provave shkresore; nuk gjendet në kushtet e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme; arsyetimi i vendimit të Komisionit vjen në kundërshtim me praktikën e tij dhe të Kolegjit në raste të ngjashme, akt kontrolli i ILDKPKI-së është absolutisht i pavlefshëm, pasi është depozituar në Komision përtej afatit ligjor.

Gjithashtu, subjekti pretendon se nuk janë respektuar një sërë të drejtash të subjektit si: e drejta e saj për t’u njohur me materialet e dosjes dhe për të marrë një kopje të tyre; e drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime në lidhje me çështjen; e drejta për të bashkëpunuar gjatë hetimit administrativ, për të kërkuar prova dhe dokumente të tjera, për të paraqitur prova dhe informacione të tjera; si dhe e drejta për t’u dëgjuar për provat e paraqitura.

- 6. *Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë në mënyrë të përmbledhur*

6.1. Lidhur me investimin në bono thesari në vitet 2004-2006, me vlerën 3.000.000 lekë

- i. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare të familjes V. dhe familjes B., subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë pasuri të luajtshme janë alogjike dhe të pabazuara në dispozitat ligjore.

- ii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se burimi i shumës në vlerën 1.500.000 lekë të depozituar prej bashkëshortit për llogari të babait N. V. kanë qenë të ardhurat e tij të përfituara nga dhënia me qira e pronave (banesave dhe dyqaneve) në qytetin e Durrësit nga viti 2000 e në vazhdim.

- iii. Burim i ligjshëm i shumës 1.500.000 lekë depozituar prej bashkëshortit kanë qenë kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat në vite (pjesa më e madhe kryesisht në vitet 2003-2004) prej pagës së saj dhe bashkëshortit A. B..

- iv. Subjekti pretendon se qëndrimi i mbajtur nga Komisioni lidhur me mënyrën e përfitimit të shumave nga të ardhurat e babait të saj, ka qenë i paragjykuar dhe jo objektiv,

nisur kjo nga standardet e ndryshme që ka mbajtur Komisioni në raste të ngjashme me subjekte të tjerë rivlerësimi².

6.2. Lidhur me gjendjen *cash* në vlerën 1.000.000 lekë

i. Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për të justifikuar krijimin e gjendjes *cash*, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, pasi në deklaratat periodike ajo dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar gjendjen e likuiditeteve dhe jo shtesat e tyre.

ii. Subjekti pretendon se në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, nuk rezulton të ketë qenë detyrim ligjor të deklarohej gjendja *cash* në banesë dhe, si rrjedhojë, për shkak të kohës ka ndodhur moskuptim apo mosinterpretim i saktë i dispozitave ligjore. Sipas subjektit termi *cash* u vendos detyrimisht pjesë e deklaramit periodik vetëm mbas miratimit të ndryshimeve të ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”.

iii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, duke mos marrë në konsideratë deklaramit periodike të saj të deklaruara në këtë formë, ka vepruar në kundërshtim, jo vetëm me ligjin, por edhe vetë praktikën³ e saj dhe të Kolegjit⁴.

6.3. Lidhur me automjetin tip “Fiat Bravo”, me targë {*}, blerë në shumën 1.000.000 lekë**

i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme e të justifikuara për blerjen e automjetit është i pambështetur në dokumentacion apo të dhëna zyrtare.

ii. Subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë të padrejtë i ka llogaritur shpenzimet për jetesë për familjen V. për vitet 1994-1999 në shumën 1.359.692 lekë, në kundërshtim kjo me jurisprudencën e Kolegjit⁵.

iii. Subjekti pretendon se njëanshmëria, paaftësia dhe kundërligjshmëria e anëtarëve të Komisionit konstatohet edhe nga fakti se në vendimin nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit që i përket bashkëshortit të saj A. B., mbi bazën e të njëjtave provave shkresore dhe të dhënave statistikore, për këtë pasuri, ka konkluduar se *bashkëshortja e tij ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.*

²Subjekti i rivlerësimit referon në vendimmarrje të tjera të Komisionit konkretisht: vendimi nr. 185, datë 23.07.2019, ndaj subjektit O. Ç.; vendimi nr. 242, datë 28.02.2020, ndaj subjektit A. V.; vendimi nr. 234, datë 04.02.2020, të subjektit M. M.; vendimi nr. 57, datë 01.08.2018, për subjektin B. K.; vendimi nr. 158, datë 29.05.2019, të subjektit Dh. L.; si dhe vendimin nr. 56, datë 01.08.2018, për subjektin D. H..

³Subjekti i rivlerësimit referon në vendimet e Komisionit nr. 49, datë 25.07.2018, (SR) A. D., nr. 104, datë 07.02.2019, (SR) E. R., nr. 43, datë 18.07.2018, (SR) N. K., nr. 207, datë 08.11.2019, (SR) A. K. dhe nr. 224, datë 20.12.2019, (SR) A. K..

⁴Subjekti i rivlerësimit referon në vendimet e Kolegjit nr. 28, datë 23.10.2020, (SR) F. V. dhe vendimin nr. 35, datë 15.12.2000, (SR) A. K..

⁵Vendimi nr. 11, datë 22.05.2019, që i përket subjekti E. I..

6.4. Lidhur me blerjen e apartamentit me sipërfaqe 70,8 m², në rrugën “Besim Imami”, Tiranë, në vitin 2001 në vlerën 28.000 USD dhe shitjen e tij më pas

i. Burimi i ligjshëm financiar për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë kursimet familjare kryesisht të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit në vitet 1991-2001, si dhe vlera 1.000.000 lekë e përfituar nga puna dhe të ardhurat e vjehrrit të saj si emigrant ekonomik në periudhën 1993-1996.

ii. Sipas subjektit, Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e saj nga paga për periudhën 1994-2001, të ardhurat nga paga e bashkëshortit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 1993-2000, të ardhurat nga pensioni të nënës dhe babait të saj, si dhe të ardhurat e vëllait.

iii. Komisioni ka aplikuar kurs këmbimi lekë-USD të pafavorshëm për periudhën 1991-2001 dhe metodologjia e përlogaritjes së shpenzimeve të jetesës është arbitrare, shifrat janë diskriminuese dhe jashtë çdo lloj logjike ekonomike dhe jetësore, si dhe janë përfshirë shpenzime jetese për gjithë vitin për fëmijën e saj të lindur në prill të vitit 2000.

iv. Lidhur me konstatimin e Komisionit për fiktivitet në shitjen e kësaj pasurie nënës së saj për vlerën 8.800.000 (tetë milion e tetëqind mijë) lekë, subjekti pretendon se janë respektuar të gjitha dispozitat e Kodit Civil mbi kontratën e shitjes dhe për të janë shlyer edhe detyrimet tatimore, me një vlerë reale pasurie pas rivlerësimit të pronës.

v. Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të nënës së saj për blerjen e pasurisë në shumën 8.800.000 (tetë milion e tetëqind mijë) lekë, subjekti pretendon se referuar dokumentacionit të dorëzuar, nëna dhe babai i saj kanë pasur të ardhura nga dhënia me qira e pronave në vlera të konsiderueshme.

vi. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të pasurisë në përdorim, subjekti pretendon se detyrimi i deklarimit është ezauruar nëpërmjet deklarimit si vendbanim në rubrikën që i përket të dhënave personale në deklaratën *vetting*.

vii. Subjekti pretendon se nuk ka kryer fshehje të kësaj pasurie pasi kjo pasuri nuk ka qenë dhe nuk është në pronësinë e saj, të bashkëshortit apo fëmijëve të saj, prandaj nuk është deklaruar si e tillë në deklaratën *Vetting*.

6.5. Lidhur me pasurinë apartament 1+1, në rrugën “{*}”, hyrja {***}, ap. {***}, Tiranë, me sipërfaqe 70 m², në pronësi të bashkëshortit**

i. Për sa i përket pamjaftueshmërisë së burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, subjekti pretendon se kanë shërbyer si burim të ardhurat e bashkëshortit të krijuara gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

ii. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera prej 2.000.000 (dy milion) lekësh e blerjes së kësaj pasurie nuk është preferenciale, pasi bashkëshorti i saj kishte dhënë konsulta juridike dhe përfaqësonte shoqërinë “{***}” ShPK në disa procese gjyqësore dhe nuk ishte shpërblyer për punën e kryer.

iii. Subjekti pretendon se kjo pasuri është përfituar nga bashkëshorti gjatë martesës me të ardhurat e tij dhe është 100% në pronësi të tij, është përdorur për aktivitetin e tij si avokat, si rrjedhojë bazuar në nenin 76 të Kodit të Familjes provohet karakteri vetjak i kësaj pasurie në pronësi të b/shortit të saj.

iv. Subjekti kërkon nga Kolegji që kostoja e ndërtimit për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, të llogaritet sipas udhëzimeve nr. 5, datë 31.05.2001, nr. 3, datë 16.10.2002 dhe nr. 1, datë 08.05.2003, të Këshillit të Ministrave për qytetin e Tiranës dhe jo sipas Udhëzimit nr. 2 datë 04.04.2007, të Këshillit të Ministrave, mbasi pallati ka përfunduar si karabina në vitin 2003.

v. Lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2007, subjekti pretendon se kjo pasuri në këtë vit nuk ka qenë në qarkullimin civil dhe është deklaruar prej bashkëshortit në vitin 2009, gjithashtu, është deklaruar në deklaratat *vetting*, si prej saj, ashtu edhe bashkëshortit, duke plotësuar në këtë mënyrë detyrimin ligjor.

vi. Subjekti pretendon se nuk ka ekzistuar asnjë konflikt interesi nga bashkëshorti i saj për të shqyrtuar çështjen penale në vitin 2016, ndaj z. A. Gj., në ngarkim të tij mbasi ky person, jo vetëm që nuk ka qenë palë në kontratën e lidhur midis bashkëshortit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, por nuk ka pasur asnjëherë cilësinë e bashkëpronarit, ortakut, administratorit apo të ketë ndonjë lloj interesi tjetër me këtë shoqëri.

6.6. Lidhur me automjetin tip “Audi A3”, me targë {*}, në pronësi 100% të bashkëshortit**

i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes së apartamentit⁶ përbëjnë burimin e ligjshëm kryesor për blerjen e pasurisë së luajtshme automjet tip “Audi A3”. Kjo kontratë nuk është fiktive, pasi ajo ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të nënës për blerjen e pasurisë apartament, si dhe ka shpjeguar në mënyrë shteruese ligjshmërinë e kontratës së shitjes së apartamentit dhe qëllimin e saj.

6.7. Lidhur me deklarimin e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur

i. Subjekti e konsideron të pabazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar deklarimin e të ardhurave të krijuara nga qiradhënia dhe avokatia, pasi për të ardhurat nga qiraja për vitet 2014, 2015 dhe 2016 ka depozituar të gjithë provat për pagimin e detyrimeve tatimore.

ii. Për të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat i bashkëshortit si avokat, subjekti pretendon se shkresat e organeve tatimore vërtetojnë se bashkëshorti i saj ka paguar të gjitha

⁶Subjekti ka shpjeguar në ankim, por edhe gjatë hetimit administrativ në Komision se bashkëshorti im ka nënshkruar kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme apartament datë 07.04.2012, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me mamanë time L. V. për një apartament me sipërfaqe 70,8 m², kundrejt shumës 8.800.000 lekë. Me një pjesë të të ardhurave të përfituara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme në datën 09.11.2012, bashkëshorti ka blerë automjetin tip “Audi A3”, me targë {***}.

detyrimet tatimore të vitit 2007 dhe për periudhën 2007-2009, bashkëshorti nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar në ushtrimin e aktivitetit si avokat.

iii. Subjekti pretendon se Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë, pasi në rivlerësimin e pasurisë⁷ së bashkëshortit të saj, mbi bazën e të njëjtave provave shkresore të ardhurat nga qiraja, i ka konsideruar të ligjshme duke i përfshirë ato në analizën financiare.

6.8. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 123 m², ndodhur në Kavajë, në pronësi 100% të subjektit të rivlerësimit e deklaruar në vlerën 4.500.000 lekë

i. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo pasuri është përfituar nga nëna L. V. si ish-pronare e truallit dhe ajo e ka përfituar në mënyrë të prejardhur prej saj.

ii. Subjekti pretendon se shuma prej 4.500.0000 lekësh e vendosur në kontratën e shitjes nuk është paguar nga nëna L. V., ndërkohë që kontrata përfundimtare e shitjes ishte mundësia e vetme që të realizohej kalimi i pronësisë në emrin e saj, situatë kjo e krijuar për shkak të vështirësive financiare të shoqërisë “{***}” ShPK.

Në përfundim të argumenteve të parashtruara, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji prishjen e vendimit nr. 418, datë 09.07.2021, të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A) Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjyqimit

I) Juridiksioni i Kolegjit dhe legjitimimi i ankuesit

Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesja, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës duke qenë subjekt rivlerësimi. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁸.

II) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Gjykimi në apel administrativ në dhomë këshillimi”, i ndryshuar, për shqyrtimin e ankimit në bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit.

⁷ Në pikën 9, faqe 20 të vendimit nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit që përket subjektit të rivlerësimit A. B. citohet: “Komisioni vendosi të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e kësaj pasurie, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore përkatëse”.

⁸Subjektit të rivlerësimit i është njoftuar vendimi i arsyetuar më datë 06.10.2021 dhe ankimi i subjektit të rivlerësimit është regjistruar në Komision më datë 21.10.2021.

Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, vendosi shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, pasi nuk ndodhemi përpara kërkesave të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në praninë e subjektit të rivlerësimit.

B) Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë zhvillimit të procedurës së rivlerësimit të saj nga ana e Komisionit janë cenuar dhe shkelur disa nga parimet themelore të përcaktuara në Kushtetutë, në ligjin nr. 84/2016 dhe Kodin e Procedurave Administrative. Sipas subjektit nuk janë respektuar një sërë të drejtash të subjektit si: e drejta e saj për t'u njohur me materialet e dosjes dhe për të marrë një kopje të tyre; e drejta për të paraqitur mendime dhe shpjegime në lidhje me çështjen; e drejta për të bashkëpunuar gjatë hetimit administrativ, për të kërkuar prova dhe dokumente të tjera, për të paraqitur prova dhe informacione të tjera; si dhe e drejta për t'u dëgjuar për provat e paraqitura.

7.1. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit rezultojnë të jenë ngritur për herë të parë në ankim dhe nuk rezultojnë që subjekti të ketë parashtruar asnjë ankesë në lidhje me pamundësinë për të ushtruar këto të drejta gjatë zhvillimit të procesit në Komision apo gjatë seancës dëgjimore.

Në funksion të zgjidhjes dhe dhënies përgjigje të këtyre pretendimeve, trupi gjykues mori në shqyrtim të gjithë veprimtarinë procedurale të zhvilluar nga Komisioni, nga ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në një komunikim të shpeshtë me Komisionin gjatë gjithë fazës së hetimit administrativ. Asaj i janë drejtuar pyetje për çështje të ndryshme dhe subjekti ka kthyer përgjigje, të cilat janë vlerësuar nga Komisioni para hartimit të raportit për rezultatet paraprake të hetimit, si edhe në vendimin e marrë për këtë çështje. Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar me pyetje subjektit edhe për çështje për të cilat ajo kishte dhënë përgjigje kontradiktore me deklaratimet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratat periodike vjetore (në vijim "DPV"). Marrja pjesë në mënyrë aktive e subjektit të rivlerësimit përgjatë procedurës hetimore, por edhe të qenit aktiv edhe në seancën dëgjimore publike, gjatë së cilës subjekti ka qenë e lirë të shpjegojë e të parashtojë prapësimet e saj, të ngrejë pretendime e të mbrohet publikisht ndaj gjetjeve të Komisionit, tregon se subjekti ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën e saj për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur.

7.2. Për sa i përket njohjes me materialet e dosjes, rezultojnë se Komisioni ka njoftuar subjektin [me vendimin nr. 3, datë 25.05. 2021], që të njihet me provat e administruara, si dhe të paraqesë pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Gjithashtu, nga aktet rezultojnë se në datën 26.05.2021, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar me shkrim se është njohur dhe ka marrë të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e saj në format *CD*, nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr, si dhe se ky dokumentacion përputhet me dokumentacionin e dosjeve që i janë vënë në dispozicion fizikisht pranë Komisionit dhe inventarit përkatës. Ky fakt dëshmon që subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia të njihet me materialet e dosjes.

8. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit për rrëzimin e disa kërkesave të saj për marrjen e provave është i paarsyetuar, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 dhe i paargumentuar për shkaqet e rrëzimit, është i pabazuar. Nga aktet e administruara rezulton se Komisioni me e-mail-in e datës 25.06.2021, i ka përcjellë subjektit vendimin e arsyetuar nr. 4, datë 21.06.2021, për refuzimin e kërkesave të saj, si dhe i ka bërë me dije se *provat e dërguara me e-mail janë pranuar dhe administruar në dosje. Ju, gjithashtu, keni të drejtën të sillni prova të tjera edhe në seancën dëgjimore*. Subjektit të rivlerësimit i është dhënë e drejta të paraqesë përgjigjet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit, sikurse dhe gjatë seancës dëgjimore të datës 07.07.2021. Komisioni ka vendosur të pranojë të gjitha provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duke i administruar ato në përputhje me nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të refuzojë kërkesat e subjektit të rivlerësimit për pyetjen e katër dëshmitarëve, këqyrjen dhe kontrollin e apartamentit në rrugën “{***}”. Komisioni e ka bazuar vendimin për refuzimin e provave në pikat 6 dhe 7, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar se e konsideron të panevojshme këqyrjen e apartamentit, si dhe të panevojshëm dhe pa ndikim në marrjen e vendimit thirrjen e dëshmitarëve. Për rrjedhojë, edhe ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

8.1. Në këtë vlerësim, vetëm pretendimi i shkeljes së parimeve të procesit të rregullt se ka pasur një vendimmarrje të kontestueshme dhe në dëm të interesave të saj nuk është element i mjaftueshëm për të kundërshtuar analizën mbi këto pretendime, të cilat duhet të lidhen patjetër me qëndrime apo veprime konkrete procedurale që pretendohen se janë kryer në shkelje të ligjit dhe që kanë sjellë si pasojë shkeljen e parimeve të procesit të rregullt, duke përbërë në këtë mënyrë një bazë të rëndësishme për cenimin e procesit të zhvilluar për këto arsye.

9. Subjekti i rivlerësimit parashtron se Komisioni i ka kaluar një barrë prove tej mundësive objektive për paraqitjen e provave shkresore, të cilat nuk gjenden as në institucionet shtetërore dhe janë jashtë afatit ligjor të ruajtjes së tyre.

9.1. Megjithëse në mënyrë të detajuar analizimi i këtij shkak do të trajtohet më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues vëren se këtë pretendim subjekti e ngre në funksion të provueshmërisë së të ardhurave nga qiraja të personit tjetër të lidhur, nënës së saj. Në këtë kuptim, ecuria e hetimit administrativ prej Komisionit, për sa i përket marrëdhënies së subjektit me nënën e saj, duket të jetë normale dhe e arsyeshme për natyrën dhe objektin e hetimit administrativ, në kushtet kur neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kërkon domosdoshmërisht verifikimet, nëse subjektet e rivlerësimit kanë burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë që disponojnë. Në funksion të kësaj dispozite, trupi gjykues çmon se subjekti të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës nga Komisioni në kuadër të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, e cila vjen në përputhje me qëllimin e këtij procesi drejt vlerësimit të burimit të krijimit të të ardhurave për krijimin e pasurive të saj.

9.2. Për sa kohë, si organet tatimore, ashtu dhe subjekti i rivlerësimit nuk kanë sjellë prova ligjore për të provuar një pjesë të qirave për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, ligjshmëria e tyre mbetet e paprovuar. Mungesa e të dhënave në sistemin elektronik nuk mund të konsiderohet si një situatë e parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë

DRT-ja nuk përcakton ndonjë nga situatat që shkaktojnë pamundësi objektive për të gjetur pagesat. Rrjedhimisht, edhe për shkak të kësaj analize, krahas asaj që lidhet me dijeninë/ndërgjegjësimin për mospagimin e detyrimeve tatimore, subjekti gjendet në kushtet kur nuk arriti të vërtetojë se dokumentacioni mbi ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga qiraja është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër ligjore.

9.3. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje se në procesin e rivlerësimit kushtetutëbërësi, në nenin Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, ka përcaktuar që barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces. Ky parim është zbrëthyer në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit të kryer nga Komisioni, për rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj.

10. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se të njëjtët anëtarë në Komision, që kanë kryer hetimin e pasurisë së saj, kanë kryer edhe gjykimin dhe kanë vendosur masën disiplinore ndaj saj, gjë që bie në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së, pasi një dublim i funksioneve mund të hedhë dyshime për paanshmërinë e këtyre anëtarëve, meqenëse nuk respekton parimin e ndarjes së funksioneve.

10.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues çmon të theksojë se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNj-së është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias⁹, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese¹⁰ dhe është konfirmuar edhe nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNj-ja, në vendimin që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹¹. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, në *Morel kundër Francës*, *Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjyqimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar¹². Dispozitat ligjore që normojnë përbërjen e trupit gjykues të

⁹[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e)

¹⁰ http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_p%C3%ABrfundimtare_100_1.php

¹¹ Të njëjtën linjë arsyetimi në funksion të zbatimit të të drejtave të procesit të rregullt rezultojnë të ketë mbajtur edhe GjEDNj-ja në vendimin që i përket *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*. Në këtë vendim, GjEDNj-ja, ndër të tjera, është shprehur se: [...] Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrësë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses, nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së [...].

¹² Paragrafët 142 – 163 të Udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil). https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SQL.pdf

Komisionit prej tre anëtarësh, përfshirë edhe relatorin/en, si dhe detyrat e këtyre të fundit – përcaktuar në nenin 14 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 – janë trajtuar gjerësisht në vendime të mëparshme të Kolegjit¹³.

10.2. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit u është nënshtruar filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, nga njëra anë, si dhe faktit që përpos kompetencës që Kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar për Komisionin, në funksion të garantimit në praktikë të zgjidhjes ligjore, ligjvënësi ka përcaktuar Kolegjin si e vetmja gjykatë e procesit që ka tagrat të kontrollojë dhe të korrigojë gjithë gabimet procedurale të konstatuara gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe, për rrjedhojë, është i pabazuar

11. Subjekti i rivlerësimit parashtron, po ashtu në ankim se trupi gjykues i Komisionit që ka gjykuar çështjen e saj nuk është krijuar, sipas pikës 1 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, pasi nuk rezulton të jetë një trup gjykues i përhershëm. Sipas subjektit të rivlerësimit, anëtarëve të Komisionit u mungon profesionalizmi dhe përvoja për të trajtuar çështjet komplekse në themel të procesit të *vetting*-ut dhe asnjë prej tyre nuk ka përvojën e nevojshme juridike dhe/ose gjyqësore dhe aftësi për gjykimin e çështjeve.

11.1. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit rithekson qëndrimin si në vendimmarrjet e mëparshme të tij duke rikonfirmuar se mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit është rregulluar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Nga aktet në fashikull rezulton se trupi gjykues dhe relatori i çështjes në Komision janë caktuar në respektim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe të Rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”. Sa i përket pretendimit për përvojën dhe aftësinë për gjykimin e çështjeve, sjellim në vëmendje, sërish vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹⁴ dhe jurisprudencën e Kolegjit

¹³Vendimi nr. 40, datë 22.10.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit S. H., paragrafi nr. 27, vendimi nr. 35, datë 22.09.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit E. Sh., paragrafi nr. 23, vendimi nr. 33, datë 19.07.2022 që i përket subjektit të rivlerësimit A. Xh. paragrafi nr.24.

¹⁴ Konkretisht, në paragrafët 300, 288 dhe 282, përkatësisht GjEDNJ-ja arsyeton:

“[...] Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (shih paragrafin 123 më lart). Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (shih paragrafin 124 më lart) [...].

[...] Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin, se si KPK-ja, ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime, duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar ‘gjykatës’, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj [...]

[...] Gjykata, më tej, përsërit se një organ, i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një ‘gjykate’, në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të gjykatës, një ‘gjykatë’ karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo, gjithashtu, duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, ‘të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutiv, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj [...]’, (shih Guðmundur Andri Ástráðsson, cituar më lart, paragrafi 219, dhe

në interpretim të dispozitave ligjore që rregullojnë kriteret dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimi. Për sa më lart, pretendimet e subjektit të rivlerësimit që lidhen me mënyrën e funksionimit të Komisionit janë të pabazuara.

12. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se personi që ka hartuar analizën financiare ka qenë i paaftë profesionalisht, pasi konkluzionet ekonomike financiare janë diametralisht të kundërta me ato të pasqyruara në vendimin nr. 211, datë 18.11.2019, që i përket bashkëshortit të saj A. B., trupi gjykues sjell në vëmendje se pranë Komisionit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përmbush detyrat dhe ushtron përgjegjësinë sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të rivlerësimit. Referuar parashikimeve të nenit 22 të ligjit nr. 84/2016, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin e rivlerësimit kalimtar. Analizat financiare të kryera nga kjo strukturë i nënshtrohen debatit nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit dhe, në përfundim, lidhur me to, vendos trupi gjykues i Komisionit i ngarkuar me short për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Analiza financiare e kryer nga Komisioni është mbështetur në të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacionin financiar, pjesë e dosjes përkatëse të ILDKPKI-së, si dhe në të dhëna nga institucione shtetërore dhe subjekte të ndryshme private të administruara në dosjen e Komisionit.

Trupi gjykues çmon se, pavarësisht mospërputhjeve të vlerave financiare që mund të jenë konstatuar nga Komisioni, për sa kohë vendimi i Komisionit i nënshtrohet kontrollit nga ana e Kolegjit, në pikën fundore të saj këto mospërputhje të pretenduara marrin zgjidhje dhe përgjigje përfundimtare në korrigjimin që kryhet mbi këtë analizë për ato çështje/zëra për të cilat janë ngritur pretendime nga subjekti i rivlerësimit në ankimin e paraqitur në Kolegj. Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vlerësimi përfundimtar i Komisionit, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, përbën një shkelje të rëndë të nenit 6 të KEDNj-së, të pikës 1, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 e detyrojnë Komisionin të kryejë procesin e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve në mënyrë të domosdoshme.

13.1. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues sjell në vëmendje së pari se neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që vendimi përfundimtar nga institucionet e rivlerësimit “[...] merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”. Ky përcaktim i qartë ligjor dhe frymë e ligjit gjendet edhe në parimin e përcaktuar nga ligjvënësi, sipas të cilit për konfirmimin në detyrë nevojitet kalimi me sukses i të tria kriterëve të rivlerësimit në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016¹⁵. Mbi bazën e këtyre premisave është kryer edhe procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj.

referenca cituar aty). Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i ‘gjykatës’ (shih, Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës, nr. 40575/10 dhe 67474/10, paragrafi 139, 2 tetor 2018, dhe referencat e cituara në të)”.

¹⁵ Neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “1. Konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet e mëposhtme: (a) kur arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) kur arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) kur arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. 2. Parashikimi i paragrafit të mësipërm nuk zbatohet për rastin e parashikuar në nenin 61, pika 5, të këtij ligji [...]”.

Rezarta Balliu dhe mbi të njëjtën bazë ligjore, referuar kjo dhe jurisprudencës së Kolegjit¹⁶ në vendimmarrjet e arritura nga Komisioni mbi bazën vetëm të kriterit të rivlerësimit të pasurisë. Në këto kushte, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

14. Subjekti pretendon se Komisioni është bazuar vetëm në të dhënat dhe provat e aktit përfundimtar të kontrollit të pasurisë të ILDKPKI-së, i cili nuk duhej të merrej në konsideratë nga Komisioni, si një akt absolutisht i pavlefshëm që nuk mund të sjellë asnjë pasojë juridike. Ky akt kontrolli, sipas subjektit të rivlerësimit, është depozituar në Komision përtej afatit ligjor prej jo më vonë se 180 ditë nga dita e depozitimit të deklaratës së pasurisë nga subjekti i vlerësimit, të parashikuar në pikën 4, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

14.1. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues analizoi aktet e ndodhura në fashikujt e përcjellë nga Komisioni nga përmbajtja e të cilëve rezulton se Komisioni në vendimin e tij nuk është bazuar vetëm në të dhënat dhe provat e paraqitura në Raportin e ILDKPKI-së, por edhe në provat e administruara gjatë hetimit, përgjigjet e subjektit në pyetësorë, parashtrimet, si dhe në provat e depozituara në funksion të barrës së provës. Në lidhje me aktet e marra në konsideratë nga Komisioni në funksion të vendimmarrjes, vendimi është bazuar në një sërë dokumentesh të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, ndër vite, akte të administruara në funksion të hetimit administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet me shkrim të përcjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit etj. Në këto kushte, ky pretendim nuk qëndron.

Së dyti, nga përmbajtja e nenit 108/ç të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton që vonesa në dorëzimin e një akti nuk është parashikuar si një nga rastet që pasjellin pavlefshmërinë e aktit administrativ¹⁷, pasi nuk përbën një shkelje thelbësore të ligjit lidhur me kompetencën e organit publik, procedurën e nxjerrjes së tij apo formës dhe elementë të tjerë të detyrueshëm. Nga dispozita e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, rezulton që afati 180 ditë është një afat orientues, me synim strukturimin e procesit të rivlerësimit që kryen Komisioni për fillimin e punës në një kohë sa më të afërt me atë të hyrjes në fuqi të ligjit. Kryerja e kontrollit dhe dërgimi i raportit që i përket subjektit të rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, pas afatit 180-ditor, duke nisur nga data e plotësimit të deklaratës së pasurisë prej tij, nuk rezulton të ketë ndikuar në përmbajtjen e këtij akti, peshën në vlerësimin tërësor të procesit të kontrollit të pasurisë, ushtrimin e ndonjë të drejte që gëzon subjekti i rivlerësimit në këtë proces, përpos faktit që nuk rezulton të ketë kushtëzuar hetimin administrativ të kryer nga Komisioni në ndonjë mënyrë apo aspekt tjetër procedural apo ligjor.

¹⁶ Ndër të tjera, pasqyruar në vendimet e Kolegjit, që lidhen me subjektin e rivlerësimit A. Xh. [nr. 9/2018 (JR)], paragrafi 44; vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit D. Rr. [nr. 15/2019 (JR)], paragrafi 119, vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit T. N. [nr. 11/2018 (JR)], paragrafi 5, vendimi që lidhet me subjektin e rivlerësimit A. Z. [nr. 2/2019 (JR)], paragrafi nr. 35.2.

¹⁷ Neni 108/ç parashikon: "Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: (a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjisllacionit në fuqi lidhur me: (i) kompetencën e organit publik; (ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose (iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; (b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; (c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjisllacionit penal; (ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj".

15. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se arsyetimi i Komisionit, në vendimin objekt shqyrtimi, vjen në kundërshtim me praktikën e Komisionit dhe të Kolegjit në raste të ngjashme, trupi gjykues sjell edhe njëherë në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se: *“Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kritereve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje¹⁸ të mëparshme të tij”.*

Subjekti pretendon në ankim se Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë, pasi në rivlerësimin e pasurisë¹⁹ së bashkëshorti të saj, mbi bazën e provave të njëjta shpresore, të ardhurat nga qiraja i ka konsideruar të ligjshme duke i përfshirë ato në analizën financiare. Trupi gjykues çmon të theksojë se megjithëse objekt të shqyrtimit të tij ka vendimin e Komisionit që përket subjektit Rezarta Balliu, në një vështrim të përgjithshëm krahasues të vendimeve, konstaton se Komisioni në vendimin nr. 211, datë 18.11.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit A. B. ka llogaritur dhe ka përfshirë në analizë vetëm ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, dhe që i përkasin një periudhe pas vitit 2013. Po kështu, në të njëjtën mënyrë Komisioni ka përlllogaritur edhe të ardhurat e përfituara nga qiraja në vitet 2014-2016, në vendimin²⁰ që i përket subjektit Rezarta Balliu, për rrjedhojë pretendimi i subjektit për aplikimin e standardit të dyfishtë nga Komisioni për këto përlllogaritje është i pabazuar.

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk gjendet në kushtet e deklaramit të më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, parashikuar nga pika 1 e kësaj dispozite. Sipas subjektit të rivlerësimit ndaj saj duhej të zbatohet parimi i proporcionalitetit dhe jo të aplikohet masa ekstreme e largimit nga detyra.

16.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vëren se vendimi për shkarkimin e subjektit është marrë pasi është konstatuar se ajo nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të saj dhe personave të lidhur, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, si rrjedhojë, është në kushtet e parashikuara në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33 të këtij ligji, për deklaramit të pamjaftueshëm të pasurisë. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit është gjetur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për disa pasuri, ka kryer deklaramit të rremë dhe të pasaktë. Me fjalë të tjera, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit ka ardhur në zbatim të përcaktimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklaramit të pamjaftueshëm. Vërtet subjekti nuk gjendet në kushtet e deklaramit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, por asnjë prej paragrafëve përbërës të kësaj dispozite nuk sugjeron se ato përbëjnë kritere të cilat duhet të përmbushen në mënyrë kumulative. Përkundrazi, situatat ligjore të cilat pasjellin shkarkimin

¹⁸Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 7/2019 (JR), nr. 34/2021 (JR).

¹⁹Në pikën 9, faqe 20 të vendimit nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit që përket subjektit të rivlerësimit A. B. citohet: *“Komisioni vendosi të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e kësaj pasurie, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore përkatëse”.*

²⁰Në pjesën e analizimit të pasurisë dhe konkretisht, njësisë me sipërfaqe 151,20 m², ndodhur në Durrës rezulton se subjekti Rezarta Balliu ka në zotërim 1/3 e pjesës së kësaj pasurie (objekt “lokal”), e cila është dhënë me qira.

nga detyra, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, janë situata ligjore autonome²¹, në këtë kuptim mjafton të gjendet e plotësuar një prej kushteve të parashikuara në njërin prej pikave për të pasjellë dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për sa më lart, por dhe referuar vendimeve të mëparshëm të Kolegjit²², ky pretendim është i pabazuar në ligj.

17. Subjekti i rivlerësimit, si në kërkesën e depozituar në Komision, ashtu edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, kërkon që të kryhet edhe vlerësimi për kontrollin e figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

17.1. Në funksion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues konstaton se nga aktet në fashikull rezultojnë që Komisioni ka administruar raportet nga KLGj-ja dhe nga DSIK-ja në lidhje me vlerësimet e aftësive profesionale dhe të figurës së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin për subjektin e rivlerësimit Rezarta Balliu, mbështetur në gjetjet e konstatuara për një nga tri kriteret e vlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë. Ky vendim mbështetet në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilës rivlerësimi mund të kryhet edhe mbi bazën e një kriteri. Konfirmimi në detyrë kërkon plotësimin me sukses të kontrollit në të tria kriteret, ndërsa moskalimi me sukses, qoftë edhe të njërit prej kriterëve është shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në përmbledhje sa më lart, trupi gjykues vlerëson se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e vlerësimit edhe për dy kriteret e tjera, për sa kohë që ai nuk sjell asnjë argument dhe provë shtesë në drejtim të kësaj kërkesë, është i panevojshëm, në kushtet kur kontrolli i kriterëve të tjera nuk do të sillte asnjë ndikim në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, hetimi i tyre do të përbënte një tej zgjatje të pajustificueshme të procesit.

18. Në përfundim të analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se është shkelur e drejta për një proces të rregullt ligjor, trupi gjykues konstaton se nuk është ilustruar me veprime të kryera nga Komisioni. Referuar dispozitave të nenit 179/b të Kushtetutës, nenet 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit ushtrojnë funksionet si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në analizë të akteve në fashikull, duke pasur parasysh sidomos, por jo vetëm, procesverbalin e seancës gjyqësore, pyetësorët, korrespondencën mes subjektit dhe Komisionit, nuk konstatohen veprime të Komisionit të cilat në vetvete mund të përbënin cenim

²¹Neni 61 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: "Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezultojnë se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të. 2. Kur rezultojnë me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bënë të pamundur vazhdimin e detyrës. 3. Kur rezultojnë se ka bërë deklarament të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji. 4. Kur rezultojnë si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. 5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit".

²²Shih, ndër të tjera, paragrafët 22.15 të vendimit të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Z. [JR 19.2019], paragrafin 21.2 të vendimit të Kolegjit nr. 22/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I. M..

të së drejtës së subjektit për një proces të pavarur dhe të paanshëm apo janë tejkalim i tagrave të Komisionit për vendimmarrje apo hetim.

C) Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

19. Lidhur me investimin në bono thesari në vlerën 3.000.000 lekë, blerë në vitet 2004 – 2006

19.1. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për investime në bono thesari, nuk u provuan burimet e ligjshme lidhur me kursimet e saj dhe të bashkëshortit, si dhe të ardhurat e babait të subjektit për blerje bonosh thesari, nuk u provua kthimi i interesave të përfituara prej babait të saj, si dhe të ½ e vlerës së bonove. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimet e ligjshme për krijimin e bonove të thesarit, në përputhje me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar investimet e kryera.

19.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se burimi i krijimit të shumës në vlerën 1.500.000 lekë të depozituar prej bashkëshortit për llogari të babait N. V. kanë qenë të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pronave (banesave dhe dyqaneve), në qytetin e Durrësit, nga viti 2000 e në vazhdim²³, të ardhurat në shumën prej 2.450 USD nga vendimi nr. {***}, datë 24.01.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pensionet e prindërve dhe të ardhurat e vëllait, që në atë kohë jetonte me prindërit. Ndërsa si burim i ligjshëm i shumës 1.500.000 lekë depozituar prej bashkëshortit kanë qenë kursimet familjare të krijuara nga të ardhurat në vite (pjesa më e madhe kryesisht në vitet 2003-2004), prej pagës së saj dhe të bashkëshortit A. B..

Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pasurive të babait të saj të konsiderohen të ligjshme dhe të bëhen pjesë e analizës së saj financiare, pasi nëpërmjet kontratave të qirasë dhe aktit të ekspertimit kontabël ka provuar në mënyrë shteruese ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja dhe pagimin e detyrimeve tatimore.

19.3. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri ka deklaruar: *“Bono thesari për periudhën 24.06.2004-24.12.2007. Burimi i krijimit 1.500.000 lekë nga të ardhurat familjare dhe 1.500.000 lekë të depozituara në favor të babait N. V. (për pamundësi fizike). Vlera 3.000.000 lekë, pjesa ¼ në %”*.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit në rubrikën *“Informacion Konfidencial”* ka deklaruar vlerën 3.000.000 (tre milion) lekë në Bankën e Shqipërisë, ndërsa në rubrikën *“Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”* ka deklaruar shumën 1.500.000 (një milion e pesëqind) lekë detyrim ndaj N. V.. Në deklaratën e

²³Subjekti pretendon se nga kontratat e qirasë të depozituara, por edhe nga vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 10.06.2002, i Gjykatës së Apelit Durrës (faqe 4 dhe 5) rezulton se babai i saj ka dhënë pasuritë e tij me qira që në datën 11.12.2000, shtetasit P. C. (një apartament) dhe në datën 09.12.2000 (një dyqan) ia ka dhënë me qira shtetas V. B..

interesave periodike të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi tërheqjen e shumës 2.500.000 lekë bono thesari nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.01.2020, ka informuar Komisionin se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimi A. B.: ka pasur nga periudha 24.06.2004 deri më datë 21.12.2006, bono thesari në vlerën nominale 3.000.000 lekë; nga data 04.01.2007 deri në datën 24.12.2007 ka pasur në zotërim bono thesari në vlerën nominale 2.500.000 lekë; në datën 24.12.2007 ka shitur bonot e thesarit në vlerën nominale 2.500.000 lekë te “Raiffeisen Bank” dhe pas kësaj date nuk ka pasur në zotërim bono thesari në llogarinë e tij pranë Bankës së Shqipërisë.

Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.01.2015, nëna e subjektit, znj. L. V., midis të tjerave, ka deklaruar se: *“I ndjeri N. V. (bashkëshorti im), meqenëse ishte në moshë të vjetër, i ka dhënë dhëndrit A. B. shumën prej 1.500.000 lekësh për të blerë bono thesari në Bankën e Shqipërisë, vlefata të cilat i janë kthyer përsëri prej tij [...]”*.

19.4. Në analizë të akteve në fashikull dhe shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se mbetet e paprovuar me dokumentacion se babai i subjektit ka qenë pronar i ½ së shumës së investuar prej bashkëshortit të saj në bono thesari, pasi ky fakt nuk është deklaruar në DPV-në e vitit 2004, si dhe as në DPV-të vijuese, por është deklaruar për herë të parë në deklaratën *vetting* dhe duket sikur është deklaruar për efekt të procesit të rivlerësimit.

Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në deklarinimin e DPV-së të vitit 2004 referon një detyrim ndaj të atit në të njëjtën vlerë, nuk rezulton asnjë specifikim që të lidhë këtë shumë detyrimi me blerjen e bonove të thesarit apo të ndarjes në pjesë takuese midis babait dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, rezulton se nga subjekti nuk është deklaruar as kthimi mbrapsht i shumës së bonove të thesarit babait apo viti kur janë kthyer këto shuma. Referuar pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, deklarinimet e interesave private dhe pasurore të paraqitura më parë në ILDKPKI përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se babai i saj ka qenë pronar i ½ së shumës së investuar në bono thesari mbeti deklarativ. Në kundërshtim të pretendimit dhe deklarinimit të subjektit për pamundësi fizike të babait të saj për arkëtimin e shumës në bono thesari, qëndron fakti se nga dokumentacioni i përcjellë nga Banka e Shqipërisë rezulton se nëna e subjektit znj. L. V. ka kryer personalisht të njëjtin investim në bono thesari në të njëjtën periudhë kohore, në vitin 2004.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se edhe deklarata noteriale e lëshuar nga znj. L. V. rezulton pa vlerë provuese, në kushtet kur bie ndesh me faktet dhe aktet zyrtare që dokumentojnë veprime, të cilat janë të ndryshme me sa pretendohet në deklaratën noteriale.

19.5. Trupi gjykues e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e subjektit se Komisioni në mënyrë të padrejtë ka refuzuar kërkesën e saj për ta vlerësuar atë në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pasi nëse tatimet do të ishin paguar rregullisht për të ardhurat e gjeneruara nga qiradhënia e pasurive të prindërve, nga sistemi tatimor do të disponoheshin të dhëna të cilat do të reflektoheshin në shkresat kthim përgjigje të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

19.6. Lidhur me pamjaftueshmërisë e burimeve financiare të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka depozituar dokumentacionin²⁴ me qëllim vërtetimin e të ardhurave të babait nga dhënia me qira e pasurive të tij për periudhën 2000-2004, konkretisht:

Vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 10.06.2002, i Gjykatës së Apelit Durrës²⁵, me paditës N. V. (babain e subjektit) dhe dy bashkëpronarë të tjerë, ka për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis paditësve dhe të paditurit, shoqëria e ndërtimit “{***}” ShPK, lidhur me kontratën e sipërmarrjes datë 21.11.1997. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, ndër të tjera, citohet se [...] z. N. V. ka dhënë me qira apartamentin dhe dyqanin e tij prej vitit 2000 [...].

Kontrata e qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2003²⁶ dhe kontrata e qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2003²⁷, vërtetojnë faktin se babai i subjektit i ka dhënë me qira këto pasuri nga viti 2003.

Shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.04.2019 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 22.06.2021, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës²⁸, konfirmon se janë kryer dy pagesa në vitin 2003 nga z. N. V., si dhe janë kryer pagesa tatimore nga subjektet qiramarrëse të pasurive të babait të saj, por nuk mund të përcaktohet se cilës kontratë i përkasin ato.

19.7. Nga sa më lart, konstatohet se është i vërtetë fakti se babai i subjektit ka pasur në pronësi pasuri të paluajtshme, të cilat rezultojnë se i ka dhënë me qira dhe ka përfutur të ardhura prej tyre. Lidhur me të ardhurat e përfuturara nga dhënia me qira e këtyre pasurive, rezultojnë se Komisioni ka llogaritur dhe i ka marrë në konsideratë ato në vlerën prej 2.280.361 lekësh. Ndërsa për të ardhurat e përfuturara para vitit 2003, trupi gjykues çmon se edhe nëse do të merret në konsideratë pretendimi i subjektit se në mënyrë indirekte nga interpretimi i vendimit nr. {***}, datë 10.06.2002, i Gjykatës së Apelit Durrës dhe do të pranohet se babai i saj i ka dhënë me qira pasuritë në pronësi të tij, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk u paraqit dokumentacion ligjor justifikues që do të vërtetonte pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja.

19.8. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të konfirmuar diferencën negative të vlerës prej 1.500.000 lekësh të burimit të krijimit të pjesës së pretenduar të investuar prej bashkëshortit të saj në bono thesari. Për këtë qëllim, Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegjin kreu përlllogaritjet për

²⁴Vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 10.06.2002, i Gjykatës së Apelit Durrës, kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2003, kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2003, shkresa nr. {***} prot., datë 11.04.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

²⁵Subjekti pretendon se nga vendimi gjyqësor nr. {***}, datë 10.06.2002, i Gjykatës së Apelit Durrës (faqe 4 dhe 5) rezultojnë se babai i saj ka dhënë pasuritë e tij me qira që në datën 11.12.2000, shtetasit P. C. (një apartament) dhe në datë, 09.12.2000 (një dyqan) ia ka dhënë me qira shtetasit V. B..

²⁶Sipas subjektit referuar kësaj kontrate ku rezultojnë se vetëm për vitin 2003, babai i saj ka siguruar të ardhura në shumën 1.440.000 lekë (për të cilin ka paguar edhe tatimin në burim etj., kurse deri më datë 24.06.2004 ka përfutur 800.000 lekë. Pra, në total për periudhën 01.01.2003-24.06.2004 ka përfutur 2.240.000 lekë.

²⁷Sipas subjektit, referuar kësaj kontrate vetëm për vitin 2003, babai i saj ka siguruar të ardhura në shumën 3.150 USD, kurse për periudhën 01.01.2004-24.06.2004, ka përfutur shumën 1.750 USD. Pra, në total për periudhën 01.01.2003-24.06.2004 ka përfutur 4.900 USD.

²⁸Sipas subjektit, nëpërmjet kësaj shkrese vërtetohet se në vitin 2003 z. N. V. ka paguar tatimin në burim në shumën 98.890 lekë dhe nuk ka detyrime të papaguara për pronat nga viti 2000 e në vazhdim.

verifikimin e të ardhurave të krijuara nga kursimet familjare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj janë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimet e kryera, ashtu siç ka rezultuar edhe nga analiza financiare e kryer në Komision, në shumën 923.222 lekë, për investimin e kryer në bono thesari.

Në përfundim, për pasurinë Bono Thesari, investuar në vlerën 3.000.000 lekë, krijuar në vitin 2004 dhe deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të tyre, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me gjendjen *cash* në banesë, në shumën prej 1.000.000 lekësh

19.9. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e likuiditeteve *cash* të deklaruara në përputhje me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar shumën e gjendjes *cash* të deklaruar në banesë.

19.10. Subjekti i rivlerësimit në ankim e ka konsideruar të gabuar konkluzionin e Komisionit, pasi në deklaratat periodike ajo dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar gjendjen e likuiditeteve dhe jo shtesat e tyre. Subjekti pretendon se në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, nuk rezulton të ketë qenë detyrim ligjor të deklarohej gjendja *cash* në banesë dhe, si rrjedhojë, për shkak të kohës, ka ndodhur moskuptim apo interpretim jo i saktë i dispozitave ligjore, pra, ka qenë një paqartësi në plotësimin e formularit të deklarimit. Sipas subjektit termi “*cash*” u vendos detyrimisht pjesë e deklarimit periodik vetëm mbas miratimit të ndryshimeve të ligjit nr. 45/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, kështu në vitin 2016 e në vazhdim ka plotësuar me saktësi gjendjen “*cash*” në banesë, gjë të cilën e ka bërë edhe në deklaratën *vetting*.

19.11. Nga verifikimet e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar: “*Gjendje cash në banesë në vlerën 1.000.000 (një milionë) lekë, me burim krijimi kursime familjare dhe të ardhura të përfituara nga shitja e pasurisë së paluajtshme nr. {***}, datë 07.04.2012, të apartamentit 1+1 + Aneks me sipërfaqe 70,8 m², z. k. {***} nr. pasurie {***}, Tiranë, pjesa në % ½*”.

Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti ka kryer të njëjtin deklaram si në *vetting*. Në deklaratën periodike të vitit 2015, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* për blerjen e një automjeti në shumën 700.000 lekë. Në deklaratën e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *shtesë nga kursimet vjetore, gjendje cash në banesë në vlerën 200.000 lekë*. Në deklaratën e vitit 2012 dhe 2013, subjekti nuk ka deklaruar kursime në gjendje *cash*. Sikurse vërehet, subjekti nuk ka deklaruar gjendje të mbetur nga shitja e shtëpisë në vitin 2012, por as në vitet në vijim, përveç shpenzimit të deklaruar si blerje e automjetit në shumën 25.000 euro.

19.12. Në kushtet kur burimi i krijimit të vlerës *cash* të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* janë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me

sipërfaqe 70,8 m², në Tiranë, që u konsideruan si veprime fiktive me qëllim justifikimin e krijimit të pasurive të tjera (analizuar në paragrafin 21.10 të këtij vendimi), trupi gjykues vlerëson se për gjendjen *cash* të ndodhur në banesë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

Neni 4 i ligjit nr. 9049/2003 dhe formulari i deklaramit të interesave private në faqen 3, para ndryshimeve të vitit 2014, kanë pasur të përcaktuar qartë detyrimin e zyrtarit deklarues të deklarojë gjendjen e parave *cash*. Ndryshimet që solli ligji nr. 45/2014 kishin si qëllim përcaktimin e vlerës maksimale *cash* që subjektet deklaruese për herë të parë mund të mbanin dhe të deklaronin jashtë sistemit bankar, me qëllim shmangien e informalitetit, fiktivitetit dhe rritjen e transparencës. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk kishte detyrim për deklaramin e gjendjes *cash* para ndryshimeve ligjore të vitit 2014 është i pabazuar.

Trupi gjykues sjell në vëmendje se gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në këtë proces, përveçse me deklaramat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë. Deklaramet e subjektit të rivlerësimit për gjendjet *cash* të mbartura në vite, por të padeklaruara në deklaramat periodike të vitit 2012 dhe 2013, sipas detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9049/2003, janë shfaqur për herë të parë vetëm në deklaramtën e vitit 2016. Për rrjedhojë, mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit se ajo ka poseduar në fund të vitit 2012 një sasi likuiditeti, si të ardhur nga shitja e apartamentit në vitin 2012.

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, duke mos marrë në konsideratë deklaramet periodike të saj të deklaruara në këtë formë, ka vepruar në kundërshtim, jo vetëm me ligjin, por edhe vetë praktikën²⁹ e saj dhe të Kolegjit³⁰, trupi gjykues sqaron se analizimi i vendimmarrjeve të tjera nga Kolegji është trajtuar në shkaqet e ankimit me natyrë procedurale.

Lidhur me gjendjen *cash* në banesë, në shumën prej 1.000.000 lekësh, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaramtën e pasurisë *vetting*, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

20. Lidhur me automjetin tip “Fiat Bravo”, me targë {*}, blerë në shumën prej 1.000.000 lekësh, 100% në pronësi të subjektit**

20.1. Komisioni arriti në përfundimin se nuk u provuan të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, në përputhje me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë.

²⁹Subjekti i rivlerësimit referon në vendimet e Komisionit nr. 49, datë 25.07.2018, (SR) A. D., nr. 104, datë 07.02.2019, (SR) E. R., nr. 43, datë 18.07.2018, (SR) N. K., nr. 207, datë 08.11.2019, (SR) A. K., nr. 224, datë 20.12.2019, (SR) A. K..

³⁰Subjekti i rivlerësimit referon në vendimet e Kolegjit nr. 28, datë 23.10.2020, (SR) F. V. dhe vendimin nr. 35, datë 15.12.2020, (SR) A. K..

20.2. Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pambështetur në dokumentacion apo në të dhëna zyrtare, pasi në mënyrë të padrejtë i ka llogaritur shpenzimet për jetesë për familjen V. për vitet 1994-1999, në shumën 1.359.692 lekë, në kundërshtim kjo me jurisprudencën e Kolegjit³¹. Sipas subjektit, referuar metodologjisë së Kolegjit, shpenzimet e jetesës për familjen V. duhej të ishin llogaritur në shumën 700.000 lekë.

20.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në deklaratën para fillimit të detyrës viti 2003, në Formularin A-2 “*Pasuri të luajtshme me regjistrim publik*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “Fiat Bravo”, në vlerën 1.000.000 lekë, blerë me kursimet personale në pronësi 100%.

Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.01.2020, ka informuar Komisionin se në emër të Rezarta N. Balliu ka rezultuar i regjistruar automjeti me targa {***} dhe bashkëlidhur ka vënë në dispozicion dokumentacionin³² përkatës. Ky automjet është shitur nga subjekti i rivlerësimit më datë 20.06.2014.

Pretendimi i subjektit se Komisioni i ka llogaritur në mënyrë të gabuar shpenzimet e jetesës të familjes V. është i pabazuar, pasi në rast se shpenzimet e jetesës së familjes V. për vitet 1994-1999 do të llogariteshin sipas metodologjisë së Kolegjit³³, pra, në masën 30% të të ardhurave për gjyqtarët dhe 66 % për kategoritë e tjera, atëherë vlerat e llogaritura do të ishin të përafërta me ato të Komisionit.

20.4. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni është treguar i njëanshëm, pasi në vendimin nr. 211, datë 18.11.2019, të Komisionit, që i përket bashkëshortit të saj A. B., ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues çmon të theksojë se objekt shqyrtimi në këtë vendimmarrje të tij është ankimi i subjektit të rivlerësimit Rezarta Balliu, ndaj vendimit të Komisionit nr. 418, datë 09.07.2021, që i përket këtij subjekti.

Trupi gjykues i Kolegjit, me qëllim verifikimin e pretendimit të subjektit për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit Rezarta Balliu për blerjen e automjetit në vitin 1999, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor kryen përlllogaritjet, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë automjet “Fiat Bravo”, në vitin 1999. Trupi gjykues vëren se ky ndryshim i vlerave erdhi si rezultat i faktit se në analizën financiare të kryer në Kolegj, shpenzimet e jetesës kanë rezultuar më të ulta. Gjithashtu, janë përfshirë edhe të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, të rlllogaritura për periudhën 1996-1998, të cilat nuk ishin llogaritur më parë në analizën e Komisionit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit gjendet i bazuar.

³¹Vendimi nr. 11, datë 22.05.2019, që i përket subjektit E. I..

³²Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë. 14.9.1999, me palë shitëse M. Sh. dhe palë blerëse Rezarta Vigani, për blerje automjeti tip “Fiat Bravo”, në vlerën 1.000.000 lekë.

Kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2014, me palë shitëse Rezarta Balliu dhe palë blerëse D. A. për shitje automjeti tip “Fiat Bravo”, me targa {***}, në vlerën 100.000 lekë.

³³Shih paragrafin 21.41 të vendimit nr. 15/2021, datë 18.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit K. S..

21. Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 70,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 12,5 m², blerë në vlerën 28.000 USD, në rrugën “Besim Imami”, Tiranë

21.1. Komisioni i vlerësoi deklaratimet e subjektit, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, të pasakta dhe të rreme. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën (-) 3.601.170 lekë, për blerjen e kësaj pasurie dhe për të përballuar shpenzimet në vitin 2001.

Komisioni konkludoi se shitja e kësaj pasurie është veprim fiktiv i kryer për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër dhe deklaram i rremë nga subjekti lidhur me burimin e krijimit.

Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* pasurinë në posedim dhe në përdorim, ndodhur në të njëjtën adresë: rruga “{***}”, p. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë, e cila është në posedim që nga viti 2012, si dhe as burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

21.2. Lidhur me këto konkluzione të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ankim pretendimet si më poshtë.

21.2/a. Burimi i ligjshëm financiar për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë kursimet familjare nga të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit në vitet 1991-2001, si dhe vlera prej 1.000.000 lekësh, përfituar nga puna dhe të ardhurat si emigrant ekonomik i vjehrrit H. B., në Greqi. Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga puna në emigracion e vjehrrit për periudhën 1993-1996, të ardhurat nga pensioni i tij për vitet 1998-2001, si dhe të ardhurat nga asistenca dhe puna e vjehrrës së saj për periudhën 1992-2001.

21.2/b. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga paga e bashkëshortit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 1993-2000, të ardhurat nga paga e subjektit në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën 1994-1995, të ardhurat nga paga e saj si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 1995-2001, të ardhurat nga pensioni të nënës dhe babait të saj, si dhe të ardhurat e vëllait.

21.2/c. Komisioni ka aplikuar kurs këmbimi lekë-USD të pafavorshëm për periudhën 1991-2001 dhe metodologjia e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës nga Komisioni është arbitrare, shifrat janë diskriminuose dhe jashtë çdo lloj logjike ekonomike dhe jetësore, meqenëse janë përfshirë shpenzime jetese për gjithë vitin për fëmijën e saj të lindur në prill të vitit 2000.

21.2/d. Sipas subjektit, fakti që Komisioni nuk ka aplikuar metodologji të saktë konstatohet nga diferencat e ndryshme negative të llogaritura në vendimin e Komisionit që i përket bashkëshortit të saj A. B. për të njëjtën pasuri, në dallim me diferencat negative llogaritur për subjektin e rivlerësimit.

Për burimet e krijimit të kësaj pasurie

21.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* gjendet: kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.07.2001, me palë

shitëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palë blerëse A. B., për blerje apartamenti, me sipërfaqe 70,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 12,5 m², rruga “{***}”, Tiranë, vlera totale 28.000 USD.

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. B. për pasurinë e sipërcituar ka deklaruar si burim vetëm të ardhurat personale dhe kursimet familjare, si dhe 100% në pronësi të tij.

Në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin me sipërfaqe 70,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 12,5 m², blerë në vlerën 28.000 USD, në rrugën “{***}”, Tiranë, pjesa takuese 50 %, ndërsa si burim të blerjes së kësaj pasurie ka deklaruar kursimet personale të saj dhe të bashkëshortit, si dhe vlerën 15.000 USD, dhuratë nga babai i saj N. V..

Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision nr. {***} prot., datë 24.04.2020, subjekti ka shpjeguar se: *“Burim i ligjshëm për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2001 janë të ardhurat familjare nga pagat e mia dhe të bashkëshortit, si dhe kursimet e prindërve të bashkëshortit, ku përfshihet edhe vlera 1.000.000 lekë që bashkëshortit tim i është dhuruar nga babai i tij dhe për këtë nuk kemi kryer ndonjë akt mbasi ky veprim është bërë në kushtet e qenies brenda një familje dhe mirëbesimit, për më tepër që ky veprim nuk kërkon domosdoshmëri të kryhet apo regjistrohet në ndonjë organ me një akt formal”.*

21.4. Trupi gjykues konstaton se vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision subjekti ka deklaruar se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer të ardhurat e babait të bashkëshortit, ndryshe nga sa ka deklaruar bashkëshorti i saj në deklaratën *vetting* dhe në deklarimin fillestar të vitit 2003.

Një fakt tjetër kontradiktor lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie paraqitet edhe në dokumentin provues për dhënien e dhuratës 15.000 USD nga babai i subjektit, për të cilën subjekti ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale të datës 09.01.2015 të nënës, znj. L. V.. Në këtë deklaratë nëna e saj ka deklaruar se bashkëshorti i saj, z. N. V., i ka falur vajzës një pjesë të të ardhurave të tyre nga qiratë e pronave, në shumën 15.000 USD, rreth viteve 2002-2004, për të blerë një banesë në Tiranë. Nga përmbajtja e kësaj deklaratë, rezulton se shuma është deklaruar me destinacion apartamentin në Tiranë, fakt që bie ndesh me pretendimin e subjektit se shumën në fjalë [15.000 USD] nuk e ka përdorur për blerjen e apartamentit.

Në vijim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie janë kontradiktore dhe të pasakta.

21.5. Subjekti i rivlerësimit, me qëllim provimin e mundësisë financiare të vjehrrit të saj, ka depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision: kontratë huaje nr. {***}, datë 03.06.1996, të vjehrrit me shoqërinë “{***}”; pasaportën nr. {***} të shtetasit H. B.; mandatpagesë nga BKT-ja, datë 20.02.1997; mandatarkëtimi datë 24.07.1998; si dhe dokumentacionin bankar për fonde të depozituara nga vjehri i subjektit të rivlerësimit në banka të nivelit të dytë, në vitet 2004-2011.

21.6. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e sipërcituar, vëren se kontrata e huas provon vetëm se vjehri i subjektit ka dhënë hua shumën prej 1.000.000 (një milionë) lekësh, në vitin 1996, të cilat i janë kthyer në vitin 1997, ndërsa nuk ka detaje për origjinën dhe fatin

e të ardhurave nga viti 1997 deri në vitin 2001, kur është blerë apartamenti nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit apo gjurmë të ekzistencës së kësaj shume. Kopja e pasaportës të vjehrrit të saj provon ligjshmërinë e hyrjes dhe qëndrimit në Greqi të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, por jo punësimin, kohëzgjatjen e tij apo dhe ligjshmërinë e të ardhurave nga punësimi në këtë shtet. Lidhur me dokumentacionin bankar për fonde të depozituara nga babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në banka të nivelit të dytë, në vitet 2004-2011, rezulton që periudha kohore e tyre nuk përkon me atë të blerjes së apartamentit, si dhe nuk ka gjurmë dokumentare të këtyre fondeve që do të lejonin identifikimin e origjinës së tyre.

Për sa më lart, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues nga punëdhënësi i H. B., në Greqi, me qëllim vërtetimin e punësimit të tij në shtetin grek apo të provojë vlerën e pagesës së përfituar dhe periudhën kohore të përfituar.

21.7. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë, jo vetëm ekzistencën dhe vlerën e të ardhurave të vjehrrit të saj, por nuk u provua edhe ligjshmëria e tyre, sipas parashikimeve të përcaktuara në nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, nenin 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të IKDKPKI-së nr. 4095/201620, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në çështje të trajtuara, ndër vite, për të ardhurat e pretenduara me prejardhje nga emigracioni³⁴.

Si rrjedhojë, nuk u provuan burimet e ligjshme për blerjen e apartamentit në vitin 2001, në shumën 28.000 USD, si dhe mbulimi i shpenzimeve të mobilimit.

Shitja e apartamentit objekt shqyrtimi

21.8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e ndodhur në fashikuajt e përcjellë nga Komisioni, konstaton, si vijon.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim “AShK”) Drejtoria Vendore Tirana Veri, me shkresën nr. {***} prot., datë. 05.03.2020, informon Komisionin se apartamenti me sipërfaqe 70,8 m², nr. pasurie {***}, z. k. {***}, vol. {***}, fq. {***}, ka qenë në pronësi të A. B. dhe i është shitur shtetasës L. V. në datën 07.04.2012. Referuar përgjigjes së AShK-së, rezulton se garazhi me sipërfaqe 12,5 m² është akoma në pronësi të z. A. B..

Në dokumentacionin e përcjellë nga AShK-ja gjendet: certifikatë provizore për regjistrimin karabina më datë 29.03.2012, të apartamentit me sip. 70,8 m², rruga “{***}”, Tiranë, në pronësi të A. B., me shënimin *vlera e pasurisë së rivlerësuar më datë. 15.03.2012 është 8.800.000 lekë*; kontratë shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.04.2012, me palë shitëse A. B. dhe palë blerëse L. V., për shitjen e apartamentit me sip. 70,8 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën 8.800.000 lekë, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

21.9. Lidhur me konstatimin e Komisionit për fiktivitet në shitjen e kësaj pasurie, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nënës së subjektit për vlerën 8.800.000 (tetë milion e

³⁴Shih, ndër të tjera, vendimet: JR nr. 12/2008, që i përket subjektit të rivlerësimit B. D.; JR nr. 09/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit A. Xh.; JR nr. 15/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rr.; JR nr. 06/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit A. S.; JR nr. 32/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit B. M.; si dhe JR nr. 14/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I. B..

tetëqind mijë) lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se janë respektuar të gjitha dispozitat e Kodit Civil mbi kontratën e shitjes dhe për të janë shlyer edhe detyrimet tatimore, me një vlerë reale pasurie pas rivlerësimit të pronës.

Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të nënës së saj për blerjen e pasurisë në shumën 8.800.000 lekë (tetë milion e tetëqind mijë) lekë, subjekti pretendon se referuar dokumentacionit të dorëzuar, nëna dhe babai i saj kanë pasur të ardhura nga dhënia me qira e pronave në vlera të konsiderueshme. Sipas subjektit kontratat e qirasë dhe shkresat e Drejtorisë së Tatimeve vërtetojnë ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga qiraja.

21.10. Nga verifikimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së dhe deklaratës *vetting* rezulton se:

Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar në rubrikën “*Angazhime nga veprimtari private dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*” të ardhura të bashkëshorti A. B. në vlerën 8.8 milion (tetë milion e tetëqind mijë) lekë nga kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.04.2012. Gjithashtu, ashtu siç u analizua më lart si burim për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën prej 1.000.000 (një milionë) lekësh, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit nënës së saj.

Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, A. B., në deklaratën e pasurisë *vetting* e ka deklaruar apartamentin në fjalë në rubrikën “*Deklarimi i pasurive*”, me pjesë takuese 100%. Në rubrikën “*Angazhime nga veprimtari private dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*”, ka deklaruar të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti në vitin 2012, në vlerën 8.8 milion lekë. Gjithashtu, si burim krijimi, për blerjen e automjetit [Audi A3] në vlerën 25.000 euro, ka deklaruar të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti.

Në deklaratën e interesave periodike vjetore të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit Rezarta Balliu ka deklaruar shitjen e apartamentit nënës së saj dhe të ardhurat e përfituara kanë qenë burim për blerjen e një automjeti [Audi A3], në vlerën 25 mijë euro në të njëjtin vit.

Nga sa më sipër, por edhe nga analiza e akteve në fashikull, përfshirë deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato periodike, rezulton se kontrata e shitjes është e vetmja gjurmë që ka lënë ky veprim juridik. Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar gjendjen *cash* në fund të vitit 2012, sikurse në asnjë nga vitet pasardhëse shumë që do t'i korrespondonte vlerës së mbetur pas blerjes së automjetit në vitin 2012. Për herë të parë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash*, duke iu referuar të ardhurave nga shitja e apartamentit, në deklaratën periodike të vitit 2016, plotësuar pas deklaratës së pasurisë *vetting*, në muajin mars të vitit 2017, kohë që përkon me nisjen e procesit të rivlerësimit.

Edhe në deklaratën e pasurisë [*vetting*], bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, jo vetëm që nuk ka specifikuar vlerën monetare të pretenduar se ka mbetur *cash* në shtëpi ndër vite, por e ka deklaruar apartamentin në pronësi 100%, ndonëse ka deklaruar të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

Gjithashtu, një fakt shtesë në përforcimin e argumentit se kontrata e shitjes është fiktive konstatohet edhe nga deklaratat noteriale e vitit 2015, lëshuar nga nëna e subjektit të

rivlerësimit, e cila konfirmon dhurimin e shumës 15 mijë USD, vajzës së saj për blerje apartamenti. Fakti që prindërit e subjektit pretendohet të kenë kontribuar vazhdimisht dhe rregullisht në dobi të mirëqenies financiare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj e bën të pakuptimtë faturimin ndaj tyre të vlerës së apartamentit, sipas kontratës së shitjes, ndërkohë që referuar deklarimit të subjektit në deklaratën periodike të vitit 2003, prindërit kishin kontribuar një herë për më shumë se gjysmën e vlerës së blerjes së këtij apartamenti.

Trupi gjykues, në mbështetje të këtij arsytimi, sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit të mbajtur në vendimin nr. 32, datë 28.07.2022, që i përket bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit A. B., për të njëjtën pasuri, në të cilin në paragrafët 24.3.5 shprehet se [...] *Së dyti, fiktiviteti i kontratës rezulton qartë, nëse analizohen objektivisht dhe me një logjikë të thjeshtë faktet nga ana financiare. Konkretisht, pretendohet të pranohet një kontratë, sipas së cilës vjehri dhe vjehrra e subjektit të rivlerësimit kanë paguar vlerën e plotë prej 8.8 milionë lekësh në vitin 2012, sipas rivlerësimit, për një apartament për të cilin kishin kontribuar në vitin 2001, nëpërmjet dhurimit ekuivalentin në USD të shumës 2.226.450 lekë [53% të vlerës së apartamentit] – në variantin e prezantuar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, duke shkuar kështu kontributi i tyre për të njëjtin apartament në vlerën mbi 11 milionë lekë [afërsisht]. Nga ana tjetër sipas këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë investuar 1.9 milionë lekë – ekuivalentin e 13 mijë USD ose 46% të vlerës fillestare – dhe kanë përfituar 6.9 milionë lekë nga diferenca mes kontributit të tyre në vitin 2001 dhe çmimit të tregut të aplikuar për prindërit e bashkëshortes. Pagesa e vlerës së tregut në blerjen e kësaj prone nga prindërit e bashkëshortes duket jo bindëse, sidomos në kushtet kur ata ishin dhurues të 53% të vlerës së blerjes së apartamenti, ndërsa subjekti dhe vajza e tyre përfitonte 6.9 milionë lekë edhe për shkak të dhurimit të bërë prej tyre [...], ndërsa në paragrafin 24.3.6 Kolegji shprehet se [...] Ky konkluzion është pasojë e konstatimit që mënyra sesi e prezanton raportin familjar subjekti i rivlerësimit dëshmon një balancë disproporcionale dhe alogjike, në kushtet kur parashtrihen rrethana fakti, sipas të cilave prindërit e bashkëshortes kontribuonin me dhurime përfshirë edhe duke blerë pasurinë për të cilën kanë dhuruar 53% të vlerës në dyfishin e koston fillestare apo kalojnë pronësi e përfitime në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit [siç shtjellohet për pasuritë e tjera të analizuar në vijim], ndërsa subjekti dhe bashkëshortja mbeten ndër vite në rolin e përfituesit të përhershëm dhe jo rrallë të vetëm. Kjo situatë e pretenduar, ku bamirësia, mirëkuptimi dhe favoret për shkak të marrëdhënies së afërt prind fëmijë shkon vetëm në një kah – në favor të subjektit dhe bashkëshortes – sfidon logjikën dhe, për pasojë, është jo bindëse. Përpos sa më sipër, ky raport i pretenduar marrëdhëniesh me përfitim vetëm njëkahësh është jo bindës edhe nën dritën e faktit që prindërit e bashkëshortes kanë kryer investime në blerje pronash, ndërsa nuk rezultojnë me tepri burimesh financiare, përkundrazi [...].*

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se për periudhën 2003 – 2012 evidentohen të ardhura të përfituara nga qiradhënia e pronave në Durrës nga prindërit e subjektit të rivlerësimit, sipas kontratave të qirasë depozituar nga subjekti, por nuk u vërtetua ligjshmëria e tyre, pra, pagesa e detyrimeve tatimore, duke mos u provuar në këtë mënyrë burimet e ligjshme për shumën prej 8.8 milion lekësh, që ka shërbyer për blerjen e apartamentit nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. L. V..

Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë se për këtë periudhë prindërit e subjektit kanë bërë investime në pasuri dhe investime të tjera (bono thesari, depozita dhe dhurime), për të cilat analiza financiare e kryer në Komision ka rezultuar me balancë negative për të gjitha këto transaksione, rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi.

Në përfundim nga sa arsyetuar më sipër, për pasurinë apartament me sipërfaqe 70,8 m² dhe garazh me sipërfaqe 12,5 m², blerë në vlerën 28.000 USD, në rrugën “{***}”, Tiranë, në pronësi të bashkëshortit të subjektit, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit:

- i. Ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie dhe ka mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklaramin e kryer në deklaratën e pasurisë dhe deklaratat e interesave periodike vjetore, si dhe përgjatë procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. B., ka lidhur kontratë fiktive për shitjen e këtij apartamenti, me qëllim justifikimin e krijimit të fondeve të referuara si burim për krijim pasurish në vijim. Kolegji arrin në këtë përfundim në konsideratë të faktit që subjekti nuk arriti të provojë kalimin e shumës prej 8.800.000 lekësh, me dokumentacion justifikues dhe ligjor nga nëna e saj të bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

Pasuria në përdorim me sipërfaqe 118 m², ndodhur në të njëjtën adresë, rruga “{}”, Tiranë***

21.11. Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* pasurinë në posedim dhe në përdorim, ndodhur në të njëjtën adresë: rruga “{***}”, p. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë, e cila është në posedim që nga viti 2012, si dhe as burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

21.12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se detyrimi i deklarimit të përdorimit të pasurisë në pronësi të vjehrrit është ezauruar nëpërmjet deklarimit si vendbanim në rubrikën që i përket të dhënave personale, në deklaratën *vetting*. Kjo pasuri i përket vjehrrit të saj dhe nuk e bën atë person të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, megjithëse vjehrrit i saj ka pasur të ardhura të konsiderueshme nga emigracioni. Subjekti pretendon se nuk ka kryer fshehje të kësaj pasurie, pasi kjo pasuri nuk ka qenë dhe nuk është në pronësinë e saj, të bashkëshortit apo fëmijëve të saj, prandaj nuk është deklaruar si e tillë në deklaratën *vetting*.

21.13. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.05.1999, shoqëria “{***}” ShPK, me cilësinë e shitësit i ka shitur z. H. B. (vjehrrit të subjektit) me cilësinë e blerësit, apartamentin me sipërfaqe 118 m². Kjo pasuri rezulton e deklaruar si adresë vendbanimi nga subjekti duke filluar nga deklarata periodike e vitit 2013 dhe ndodhet në të njëjtën ndërtesë me pasurinë me sipërfaqe 70,8 m², rruga “{***}”, Tiranë, analizuar më lart.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ardhur me shkresën nr. {***} prot., datë 24.04.2020, subjekti ka shpjeguar se nga viti 2012 e aktualisht jetoj në banesën me adresë: Njësia Administrative nr. {***}, rruga “{***}”, pallati {***}, shkalla {***}, apartamenti {***}, Tiranë, i cili është në pronësi të vjehrrit H. B. dhe meqenëse nuk është në pronësinë time, nuk kam pasur detyrim ligjor për ta deklaruar si në deklaratimet periodike ashtu edhe në deklaratën vetting. Këtë banesë e posedoj për arsye familjare që nga viti 2012 dhe nuk kam kryer asnjë shpenzim për arredime në lidhje me këtë pasuri. Në shpjegimet pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se pasuria e tipit apartament nr. {***}, nuk ka qenë asnjëherë në pronësinë time dhe është blerë në vitin 1999 prej vjehrrit H. B. me kursimet e tij të emigracionit ekonomik të viteve 1993-1996. Kjo pasuri figuron e regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në pronësi të vjehrrit H. B. dhe që prej shitjes së apartamentit në vitin 2012, po jetojmë në shtëpinë e vjehrrit së bashku me bashkëshortin dhe fëmijët (pa qira).

21.14. Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit është i pabazuar, pasi vetëm deklarimi i adresës së vendbanimit pa dhënë asnjë të dhënë për marrëdhënien e saj afatgjatë me këtë pasuri bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe përkufizimit të pasurive që i nënshtrohen deklaratimit për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas pikës 11, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së Referuar dispozitave të sipërcituara rezultojnë qartë detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar këtë pasuri, të cilën e kishte në përdorim prej vitesh në momentin e depozitimit të deklaratës së pasurisë vetting. Po ashtu, pika 5, e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon edhe sanksionin disiplinor, në kushtet kur një subjekt rivlerësimi fsheh apo paraqet në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo posedim e përdorim.

Në vijim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting ka fshehur përdorimin e pasurisë [me sipërfaqe 118 m²], të ndodhur në të njëjtën ndërtesë me apartamentin me sipërfaqe 70,8 m². Kjo pasuri e regjistruar në emër të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar në përdorim nga subjekti, prej vitit 2012 e në vijim. Për rrjedhojë, subjekti nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

22. Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 70 m², ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë**

22.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe të rremë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Subjekti e ka blerë këtë pasuri nën çmimet e tregut dhe nuk arriti të provonte dhe dokumentonte shërbimet që ka kryer personi i lidhur (bashkëshorti i saj) si avokat ndaj shoqërisë shitëse, të ardhurat përkatëse të përfituara, si dhe as pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura të pretenduara. Me personin me të cilin ka lidhur kontratën e sipërmarrjes dhe më pas të shitjes në vitin 2015 për këtë pasuri, bashkëshorti i saj ka qenë në konflikt interesi. Komisioni vlerësoi se bashkëshorti i subjektit ka pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie dhe për të përballuar shpenzimet përkatëse sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

22.2. Subjekti pretendon në ankim se si burim për krijimin e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e bashkëshortit të krijuara gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Sipas saj, referuar shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë,

vërtetohet plotësisht se bashkëshorti i saj ka ushtruar funksionin e avokatit, si dhe ka paguar të gjitha detyrimet tatimore të vitit 2007. Të ardhurat (qarkullimi) në lekë janë deklaruar në organet e pushtetit vendor dhe bashkëshorti i saj nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar, për periudhën 2007-2009, që ka ushtruar aktivitetin si avokat.

22.2/a. Subjekti pretendon se vlera prej 2.000.000 (dy milion) lekësh e blerjes së kësaj pasurie nuk është preferenciale, pasi bashkëshorti i saj kishte dhënë konsulta juridike dhe e përfaqësonte shoqërinë “{***}” ShPK, në disa procese gjyqësore dhe nuk ishte shpërblyer për punën e kryer, gjithashtu, bashkëshorti i saj kishte marrë përsipër të vazhdonte ta përfaqësonte këtë shoqëri si avokat në proceset gjyqësore ku ishte palë, pa pagesë.

22.2/b. Subjekti kërkon nga Kolegji që kostoja e ndërtimit për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, të llogaritet sipas udhëzimeve nr. 5, datë 31.05.2001, nr. 3, datë 16.10.2002, dhe nr. 1, datë 08.05.2003, të Këshillit të Ministrave për qytetin e Tiranës dhe jo sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 04.04.2007, mbasi pallati ka përfunduar si karabina në vitin 2003.

22.2/c. Subjekti pretendon se nuk ka ekzistuar asnjë konflikt interesi nga bashkëshorti i saj për të shqyrtuar çështjen penale në vitin 2016, ndaj z. A. Gj., në ngarkim të tij mbasi ky person, jo vetëm që nuk ka qenë palë në kontratën e lidhur midis bashkëshortit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, por shtetasi A. Gj. nuk ka pasur asnjëherë cilësinë e bashkëpronarit, ortakut, administratorit apo të ketë ndonjë lloj interesi tjetër me këtë shoqëri.

22.3. Nga analizimi i deklarimeve të subjektit dhe bashkëshortit të saj për këtë pasuri rezulton se bashkëshorti i subjektit e ka deklaruar këtë pasuri fillimisht në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, në vlerën 2.900.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit, kurse në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting* e deklaroi në vlerën 2.000.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit. Ndërsa vetëm në deklaratën e interesave periodike të vitit 2015 dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, në deklarinimin e personit të lidhur është deklaruar kjo pasuri.

Sipas ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. {***} prot., datë. 24.03.2020, ka informuar Komisionin se bashkëshorti i subjektit A. B. ka në pronësi apartamentin me sipërfaqe 70 m², nr. pasurie {***}, z. k. {***}, vol. {***}, fq. {***}. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë. 17.12.2015, me palë shitëse shoqëria “{***}” ShPK dhe palë blerëse A. B. për blerje apartamenti me sip. 70 m², rruga “{***}”, Tiranë, në vlerën 2.000.000 lekë.

22.4. Trupi gjykues konstaton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar vlera të ndryshme të çmimit të blerjes së apartamentit objekt shqyrtimi, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2009, e deklaroi në vlerën 2.900.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* e deklaroi në vlerën 2.000.000 lekë.

Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se deklarimi i ndryshëm i çmimit të blerjes së apartamentit nga bashkëshorti i saj është kryer, pasi në deklaratën e viti 2009 ka përfshirë dhe shpenzimet shtesë të kryera për këtë apartament dhe deklarata e pasurisë *vetting* nuk kishte ndonjë rubrikë ku mund të pasqyroheshin shpenzimet apo investimet trupi gjykues e vlerëson

të pabazuar. Në deklaratat vjetore periodike, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë [vetting] të dhënat që kërkohen për pasuritë janë të njëjta, konkretisht në rubrikat e dedikuara përshkrimit të pasurive, kërkohet: vlera e blerjes së pasurisë, sipas kontratës së shitjes dhe në mungesë të dokumentacionit për shpenzimet e kryera, vlera e tyre³⁵. Mospërputhja e vlerës së deklaruar të apartamentit në dy deklaratat në fjalë, nuk mund t'i atribuohet mënyrës së formulimit të kërkesave në formularin e deklarimit të pasurisë, për rrjedhojë subjekti/bashkëshorti i saj ka kryer deklarim të pasaktë për vlerën e kësaj pasurie.

22.5. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2007, me palë sipërmarrëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe palë porositëse A. B. për porositjen e apartamentit me sip. 79,26 m², vlera 2.000.000 lekë. Në këtë kontratë citohet që shuma e blerjes është likuiduar nga porositësi në favor të sipërmarrësit, para redaktimit të kësaj kontrate jashtë zyrës noteriale dhe pa pretendime nga palët. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2007.

Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka pasur detyrimin për deklarim, pasi kjo pasuri në këtë vit nuk ka qenë në qarkullimin civil. Për sa kohë nga këto kontrata janë krijuar detyrime dhe janë kryer pagesa, mbështetur në nenet 4 dhe 7, pika 5 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, subjekti ka pasur detyrim ligjor të deklarojë pasuritë e saj dhe ato të blera nga bashkëshorti.

Gjithashtu, referuar dispozitave të Kodit të Familjes, pasuria e krijuar nga bashkëshorti i subjektit konsiderohet si pasuri e subjektit, përderisa ndërmjet tyre/bashkëshortëve nuk ka pasur një rregullim/marrëveshje të ndryshme për këtë fakt. Për këtë shkak, subjekti duhet të kishte deklaruar në DPV-në e vitit 2007 pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie.

22.6. Lidhur me pretendimin e subjektit se si burim krijimi të kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e bashkëshortit nga ushtrimi i profesionit të avokatit, trupi gjykues mori në analizë dokumentacionin për këtë çështje dhe konstaton se ky pretendim është i pabazuar, pasi:

Referuar shkresës nr. {***}, datë 07.07.2017, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, z. A. B. është regjistruar me NIPT {***}, për aktivitetin “Avokati” më datë 10.10.2007. Kurse kontrata e sipërmarrjes dhe pagesat për shoqërinë “{***}” ShPK janë kryer më datë 22.10.2007.

Konstatohet se pagesa e apartamentit është kryer vetëm 12 ditë pasi bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit është regjistruar për të ushtruar profesionin e avokatit. Ky fakt të krijon bindjen se është e pamundur që brenda 12 ditëve pas licencimit për të ushtruar avokatinë, bashkëshorti i subjektit të mund të kishte kryer një vlerë shërbimesh juridike për shoqërinë “{***}” ShPK, të cilat të vlerësohen minimalisht në çmimin e vendosur në kontratë në vlerën prej 2.000.000 (dy milion) lekësh. Argumenti i mësipërm përforcohet edhe me dokumentacionin e përcjellë

³⁵Në rubrikën që i dedikohet deklarimit të pasurive, formulari [shtojca nr. 4 e ligjit nr. 84/2016] shprehimisht specifikon detyrimin për deklarimin e të dhënave si vijon: “Përshkruani hollësisht [...] çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve, shumën e shpenzimeve që keni kryer [...]”. E njëjta përmbajtje rezulton edhe në kërkesat e faqes 3 të deklaratës përpara fillimit të detyrës, plotësuar nga subjekti në datën 08.10.2009.

nga Drejtoria e Tatimeve për të ardhurat e përfituara nga z. A. B. nga puna si avokat konkretisht:

Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 29.02.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë rezulton se bashkëshorti i subjektit ka realizuar të ardhura nga avokatia për vitin 2008 = 1.700.000 lekë, fitimi 600.000 lekë dhe për vitin 2009 ka realizuar të ardhura 1.950.000 lekë, fitimi 950.000 lekë. Në njoftimin e vlerësimit tatimor, datë 23.10.2007, të Bashkisë Tiranë, por edhe në mandatarkëtimin nr. {***}, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave vendore Bashka Tiranë në zërin biznes i vogël, për pagesë kësti IV është në vlerën prej 15.000 lekësh. Pra, një pagesë e tillë për detyrimet tatimore, nëse do ta konsiderojmë në masën 10 % të fitimit do të rezultonte një vlerë e përfituar nga bashkëshorti i subjektit për të gjithë tremujorin e fundit të vitit 2007, në masën 150.000 lekë. Konstatohet se vetë bashkëshorti i subjektit i rivlerësimit, për efekt të detyrimeve tatimore, ka zgjedhur të regjistrohet në kategorinë e bizneseve me xhiro vjetore nga 2 deri në 3 milionë lekë për vitin 2007.

Në këtë mënyrë, nëse do të pranohet pretendimin e subjektit për krijimin e vlerës prej 2 milionë lekësh *neto* në harkun kohor të 12 ditëve në fund të vitit 2007 do t'i kishte rezultuar me qarkullim *bruto* minimalisht rreth 4 milionë lekë, për pasojë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit do të duhet të kishte parapaguar një tatim më të lartë për vitin në vijim, por që nuk rezulton të ketë ndodhur.

Për këtë arsye, edhe nga ky këndvështrim analitik, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për burime të krijimit të apartamentit nga shërbimet juridike të kryera prej bashkëshortit të saj pasi është licencuar dhe regjistruar si avokat, bie ndesh me dokumentacionin e depozituar dhe me faktet e provuara gjatë gjykimit.

22.7. Gjithashtu, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka përfituar apartamentin objekt shqyrtimi nëpërmjet ofrimit të shërbimeve juridike, ndaj shoqërisë “{***}” ShPK nuk gjen pasqyrim as në përmbajtjen e kontratës së lidhur për shitjen e apartamentit apo nuk rezulton ndonjë akt i kohës apo marrëveshje midis palëve për këtë mënyrë likuidimi. Vendimet e gjykatës të sjella nga subjekti, në të cilat z. A. B. ka qenë pjesëmarrës në cilësinë e avokatit të shoqërisë “{***}” ShPK, i përkasin një periudhe para muajit tetor 2007 [kur është kryer transaksioni i shitjes].

Bashkëshorti i subjektit rezulton të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik (avokat) në datën 10.10.2007 dhe është pajisur me NIPT.

Për rrjedhojë, duke filluar nga data e regjistrimit, çdo shërbim i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për klientët, përfshirë shërbimet e kryera shoqërisë “{***}” ShPK, do të duhej të shoqërohej me faturë tatimore. Në kushtet kur nuk provohet gjenerimi i kësaj shume dhe as pagimi i detyrimeve tatimore që kishin lindur për shkak të përfitimit të saj, nuk përmbushet as kriteri i ligjshmërisë së këtyre të ardhurave në zbatim të përcaktimit të shprehur të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutë.

Deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., e ortakes dhe administratores së shoqërisë “{***}” ShPK, hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, e cila synon të zhbëjë sa palët kanë përcaktuar me kontratën e vitit 2007, konsiderohet pa vlerë provuese referuar nenit 690 të Kodit Civil, për peshën që kanë parashikimet e palëve në një kontratë të hartuar në përputhje

me ligjin. Si e tillë, deklarata e znj. E. D. vlerësohet si një përpyetje për të përmirësuar situatën e subjektit të rivlerësimit, parë kjo dhe në qëndrimet e mëparshme të Kolegjit³⁶.

Në përfundim, për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 70 m², ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me vlerën dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, sipas nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

22.8. Lidhur me konkluzionin e Komisionit se bashkëshorti i subjektit e ka blerë këtë pasuri nën çmimet e tregut, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që kostoja e ndërtimit për apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, të llogaritet sipas udhëzimeve nr. 5, datë 31.05.2001, nr. 3, datë 16.10.2002 dhe nr.1, datë 08.05.2003, të Këshillit të Ministrave, për qytetin e Tiranës dhe jo sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2 datë 04.04.2007, pasi pallati ka përfunduar si karabina në vitin 2003.

Nga aktet në fashikull nuk rezulton që subjekti të ketë përcjellë ndonjë akt apo të dhënë për fillimin e punimeve të ndërtimit, përfundimin e tyre apo kryerjen e procedurave të kolaudimit dhe të dorëzimit të objektit që do të lejonin të kuptohej që ndërtimi t’i atribuohet një kohe konsiderueshëm më të hershme nga kontrata e sipërmarrjes e hartuar në vitin 2007 dhe e shitjes në vitin 2015.

Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion me qëllim verifikimin, qoftë edhe në mënyrë rrethore, për ndërtimin e objektit minimalisht tre-katër vjet përpara hartimit të kontratës së sipërmarrjes, ky pretendim për kohën e ndërtimit në vitet 2001-2003 mbeti deklarativ. Gjithashtu, çmimi i aplikuar nga ndërtuesit për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit rezulton më i ulët, krahasuar kjo dhe me kontratat e paraqitura me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2019, të ZVRPP-së Tiranë, e cila ka dërguar kontratat e shitblerjeve të pasurive apartament në këtë objekt. Nga verifikimi i çmimit të shitjes në këto kontrata, bazuar në vlerën e tregut për vitet kur është kryer transaksioni, rezulton se çmimi i shitjes së apartamenteve me sipërfaqe të njëjtë prej 70 m², nga shoqëria “{***}” ShPK varion nga 29 mijë USD deri në 37.8 mijë USD. Për këtë shkak, konkluzioni i Komisionit se shoqëria “{***}” ShPK ka aplikuar një çmim më të ulët për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit është i drejtë.

22.9. Subjekti pretendon se nuk ka ekzistuar asnjë situatë e konfliktit të interesit të bashkëshortit të saj, pasi në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2015, shtetasi A. Gj. (ndaj të cilit bashkëshorti i subjektit në cilësinë e gjyqtarit relator ka dhënë vendim në Gjykatën e Apelit Durrës) nuk ka qenë as në rolin e shitësit dhe as si palë, por vetëm si përfaqësues me prokurë të përgjithshme i shoqërisë “{***}” ShPK, për nënshkrimin e kësaj kontrate. Sipas subjektit, shtetasi A. Gj. nuk ka pasur asnjëherë cilësinë e bashkëpronarit, ortakut, administratorit apo të ketë ndonjë lloj interesi tjetër me këtë shoqëri, fakt i cili vërtetohet edhe nga deklaramet e administratores së shoqërisë “{***}” ShPK, znj. E. D..

³⁶Ndër të tjerë, vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 6/2018(JR), paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), paragrafi 27.12.1; dhe nr. 34/2019(JR), paragrafi 85.2.

22.10. Nga aktet në fashikull rezulton se Gjykata e Apelit Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.04.2019, i ka përcjellë Komisionit vendimin gjyqësor nr. {***}, datë 19.05.2016, në të cilin bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. B. ka qenë kryesues në çështjen penale ndaj shtetasit A. Gj.. Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë nr. {***}, datë 02.06.2015, vendim i cili kishte vendosur: *“Pushimin e çështjes penale Nr. {***}, datë 22.04.2015, në ngarkim të të pandehurit A. Gj. për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, për shkak se ndjekja penale ndaj tij nuk duhet të vazhdojë”*.

Sikurse vërehet nga aktet, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit A. B. ka pasur njohje me shtetasin A. Gj., pasi ky i fundit ka vepruar si përfaqësues me prokurë të përgjithshme i shoqërisë “{***}” ShPK, duke nënshkruar kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2015, sipas të cilës z. A. B. përfitoi apartamentin objekt shqyrtimi. Gjithashtu, z. A. Gj., në cilësinë e ortakut dhe administratorit të shoqërisë “{***}”, ka nënshkruar kontratën e shitblerjes, në të cilën babai i bashkëshortit të subjektit ka përfutuar apartamentin në vitin 2001, analizuar më lart.

Nga sa konstatuar më lart, por duke marrë në konsideratë edhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti i saj ka punuar si mbrojtës ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK, vërehet një njohje e gjatë ndër vite midis bashkëshortit të subjektit dhe shtetasit A. Gj.. Në këto kushte, referuar nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005³⁷ “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe përcaktimeve të neni 17 të Kodit të Procedurës Penale³⁸, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk duhet të merrte pjesë në gjykimin e çështjes që i përket vendimit nr. {***}, datë 19.05.2016, sepse ekzistonin kushte serioze njëanshmërie. Përpos sa më sipër, trupi gjykues çmon se situata e konfliktit të interesit të bashkëshortit të saj nuk mund të sjell domosdoshmërisht ardhjen e pasojës me ndikim negativ apo ngarkimin me përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit në këtë proces.

23. Lidhur me automjetin tip “Audi A3”, me targa {*}, blerë në çmimin 25.000 euro**

23.1. Komisioni krijoi bindjen se bashkëshorti i subjektit është përfshirë në veprime fiktive, për sa i përket shitjes së apartamentit me sipërfaqe 70,8 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në mënyrë që të justifikojë burimin e ligjshëm për krijimin e një pasurie tjetër. Për rrjedhojë, në referim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e automjetit tip “Audi A3”.

³⁷ Neni 5 i ligjit përcakton që: “1. Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: (a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre; (b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; (c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale; [...] angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, [...] v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë; (e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni [...]”.

³⁸ Neni 17: “1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: (a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditori tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij [...]; (e) kur ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15 dhe 16; (ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie [...]”.

23.2. Subjekti pretendon se të ardhurat e përfituara nga kontrata e shitjes së apartamentit³⁹ përbëjnë burimin e ligjshëm kryesor për blerjen e pasurisë së luajtshme automjet tip “Audi A3” dhe kontrata e shitjes sipas saj nuk është fiktive, pasi ajo ka dokumentuar të ardhurat e ligjshme të mamasë për blerjen e pasurisë apartament, si dhe ka shpjeguar në mënyrë shteruese ligjshmërinë e kontratës së shitjes së apartamentit dhe qëllimin e saj.

23.3. Nga verifikimi i deklarimeve rezulton se si subjekti edhe bashkëshorti i saj e deklarojnë këtë pasuri të luajtshme në deklaratën e interesave periodike të vitit 2012. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshorti i saj e deklaroi blerjen e automjetit “Audi A3”, në vlerën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) eurosh, me burim kursimet dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 70,8 m², në datën 07.04. 2012.

Nga aktet e dosjes rezulton se DPSHTRr-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.01.2020, informon Komisionin se z. A. B. ka në pronësi automjetin me targa {***} dhe se bashkëshorti i subjektit ka nënshkruar një kontratë shitje automjeti më datë 08.11.2012 me palë shitëse “{***}” ShPK, për blerje automjeti “Audi A3” në vlerën 25.000 euro. Bashkëlidhur kontratës është një mandatarkëtim/depozitim për të tretë të “{***}”, datë 08.11.2012, sipas së cilës A. B. ka derdhur në llogari të “{***}”, për blerje makine, shumën prej 25.000 eurosh.

Konstatohet se ashtu si në deklarinimin e interesave periodike edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti pretendon se si burim për blerjen e automjetit “Audi A3” kanë shërbyer kursimet nga paga dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 70,8 m², rruga “{***}”, Tiranë, shumë e cila është mbajtur si gjendje *cash* në banesë.

Shitja e pasurisë apartament me sipërfaqe 70,8 m², rruga “{***}”, pall. {***}, shk. {***}, ap. {***}, Tiranë, është analizuar më lart në këtë vendim dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar kalimin e shumës prej 8.8 milionë lekësh, nga nëna e saj te bashkëshorti, si pasojë e shitjes së apartamentit.

Gjithashtu, është konstatuar më lart se bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratë fiktive për shitjen e këtij apartamenti me nënën e subjektit të rivlerësimit, me qëllim justifikimin e krijimit të fondeve të deklaruara si burim për krijim pasurish, për pasojë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk arrijnë të provojnë burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie.

Për pasurinë automjet “Audi A3”, në vlerën 25 mijë euro, blerë në vitin 2012, deklaruar në deklaratën *vetting*, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit me burime nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 70,8 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, Kolegji çmon se

³⁹ Subjekti ka shpjeguar në ankim, por edhe gjatë hetimit administrativ në Komision se: Bashkëshorti im ka nënshkruar kontratë shitje të pasurisë së paluajtshme apartament, datë 07.04.2012, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., me mamane time L. V. për një apartament me sipërfaqe 70,8 m², kundrejt shumës 8.800.000 lekë. Me një pjesë të të ardhurave të përfituara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme në datën 09.11.2012, bashkëshorti ka blerë automjetin tip “Audi A3”, me targë {***}.

subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet mungesës së burimeve financiare të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

24. Lidhur me deklarinimin e të ardhurave

24.1. Komisioni arriti në përfundimin se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, krijuar nga qiradhënia dhe aktiviteti i bashkëshortit, avokatia, nuk u provuan si të ligjshme në përputhje me pikën 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar deklarinimin e të ardhurave të krijuara nga qiradhënia dhe avokatia.

24.2. Subjekti e konsideron të pabazuar konkluzionin e Komisionit, pasi për të ardhurat nga qiraja e pasurisë së trashëguar prej prindërve për vitet 2014, 2015 dhe 2016 ka depozituar të gjithë provat për pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe ka konfirmimin nga organet tatimore për pagimin e detyrimeve tatimore. Ndërsa për të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat i bashkëshortit si avokat, subjekti pretendon se shkresat e organeve tatimore vërtetojnë se bashkëshorti i saj ka paguar të gjitha detyrimet tatimore të vitit 2007 dhe për periudhën 2007-2009, bashkëshorti nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar në ushtrimin e aktivitetit si avokat.

24.3. Nga verifikimi i deklarinimeve të subjektit rezultoi se në deklaratën e pasurisë *vetting* në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private/ publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*” ka deklaruar se: “*Të ardhura nga qiraja e pasurisë me sip. 105 m², ndodhur në Durrës, rruga “{***}”/3, hyrja {***}, ap. {***}, nr. pasurie {***}, z. k. {***}, që është pasuri trashëgimorë në 1/3 pjesë, sipas kontratave të qirasë⁴⁰ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2013 dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2016, për periudhën 2014 – 2016, në vlerën 600.000 lekë*”.

Në deklaratën e interesave periodike për vitet 2014, 2015 dhe 2016 konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për secilin vit përkatës ka përfutur nga dhënia me qira e pronës së sipërcituar të ardhura në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

24.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka përfutur të ardhura nga dhënia me qira e pronave në Durrës, referuar kjo kontratave të qirasë⁴¹ të depozituar nga subjekti. Lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, megjithëse shkresat e Drejtorisë Rajonale Tatimore⁴² Durrës nuk specifikojnë pagimin e tatimeve, por citojnë se për tatimin në burim [...] është e pamundur të verifikohen pagesat, pasi nuk mund të përcaktohet se cilës kontratë i përket, rezultoi se subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka depozituar

⁴⁰Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.03.2013, me palë qiradhënëse N. V. dhe palë qiramarrëse R. E. për dhënie me qira lokal me sip. 105 m², rruga “{***}”, Durrës, afati 5 vjet, vlera 50.000 lekë/muaj.

Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2016 me palë qiradhënëse L., R. e E. V. dhe palë qiramarrëse K. E., për dhënie me qira njësi me sip. 105, rruga “{***}”, Durrës, afati 5 vjet, vlera 50.000 lekë/muaj.

⁴¹Kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.03.2003; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.03.2003; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.2005; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.03.2006; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2006; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.08.2006; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2006; kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.06.2007; dhe kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.04.2012.

⁴²Shkresa nr. {***} prot., datë 30.09.2019, shkresa nr. {***} prot., datë 11.04.2019, shkresa nr. {***} prot., datë 30.12.2019; dhe shkresa nr. {***} prot., datë 25.06.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës.

kopje të urdhërpagesave të nxjerra nga bankat, për pagesën e tatimit në burim për vitet 2014-2016.

Komisioni në vendimin e tij nuk i ka specifikuar vitet përkatëse për të cilat janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat nga qiraja, por nga analizimi i dokumentacionit financiar konstatohet se ka marrë në konsideratë dhe ka llogaritur të ardhurat e përfituara nga qiraja subjektit të rivlerësimit për periudhën 2014-2016. Ndërsa për periudhën para këtyre viteve nuk u konfirmuan pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja dhe, për rrjedhojë, nuk janë përfshirë në analizë.

24.5. Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga puna e bashkëshorti si avokat, rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti i rivlerësimit ashtu edhe bashkëshorti i saj në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private/ publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*” kanë deklaruar të ardhurat nga puna si avokat e A. B. në vlerën 5.650.000 lekë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.02.2020, ka informuar Komisionin se z. A. H. B., i datëlindjes 09.11.1968, rezulton i regjistruar si person fizik, me NIPT {***} në datën 10.10.2007 dhe çregjistruar në datën 19.09.2015. Subjekti ka dorëzuar në sistemin tatimor deklaratat e “*Tatim fitimi i thjeshtuar*” për periudhën 2008- 2010, nga ku rezulton me fitim prej 600.000 lekësh për vitin 2008 dhe 950.000 lekësh për vitin 2009, ndërsa për vitin 2007, referuar të dhënave të Bashkisë Tiranë, konkretisht formularit njoftim vlerësimi tatimor për tremujorin e fundit të vitit 2007, të ardhurat llogariten në vlerën 150.000 lekë.

Sikurse konstatohet sa më lart, referuar dokumentacionit të organeve tatimore, vlerat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit janë disa herë më të ulëta se ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*.

Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se deklarimi i të ardhurave në vlerën 5.650.000 lekë është një pasaktësi është i pabazuar, pasi vlera e deklaruar në deklaratën *vetting* nuk përkon as përafërsisht me vlerat e konfirmuara nga organet tatimore.

Gjithashtu, më pak të besueshëm e bën pretendimin e subjektit për këtë vlerë të deklaruar edhe fakti që për dy vitet bashkë 2008-2009 pretendon të ardhura *neto* në vlerën 1.550.000 lekë, ndërsa për vitin 2007, sipas saj, të ardhurat *neto* ishin 2.000.000 lekë, në një kohë që për vitin 2007 bashkëshorti i subjektit e ka ushtruar profesionin e avokatit vetëm për 3 muaj.

Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga qiradhënia dhe aktiviteti i bashkëshortit të saj/avokatia, Kolegji çmon se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre të ardhurave, gjë e cila ka afektuar dhe në krijimin e pasurive të subjektit, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

25. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 123 m², në Kavajë, në pronësi 100% të subjektit të rivlerësimit

25.1. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni konstatoi se *subjekti, nuk arriti të qartësojë pozicionin e saj në lidhje me veprimet juridike të ndërmarra me shoqërinë e ndërtimit, ku nënshkruan kontratën e sipërmarrjes në cilësinë e pronares së truallit, kur ndërkohë nuk ishte ajo pronare mbi këtë pasuri. Gjithashtu, subjekti ka nënshkruar kontratën e shitblerjes, sipas së cilës thuhet se çmimi i blerjes likuidohet nga nëna dhe ndërkohë apartamenti është përfituar pa pagesë, sikurse deklaroi subjekti. Sipas Komisionit këto veprime ligjore të kryera nga subjekti i rivlerësimit janë të papranueshme dhe përfitimi i kësaj pasurie nga subjekti nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë mënyrën e fitimit të pronësisë, nëpërmjet marrëdhënies së shkëmbimit. Kalimi i pronësisë së apartamentit direkt te subjekti është bërë në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi. Me këto veprime të kryera nga subjekti janë shmangur detyrimet financiare në favor të buxhetit të shtetit.*

25.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo pasuri është përfituar nga nëna e saj, znj. L. V., si ish-pronare e truallit dhe ajo e ka përfituar në mënyrë të prejdardhur prej saj. Ndërsa shuma prej 4.500.0000 lekësh e vendosur në kontratën e shitjes nuk është paguar as nga ajo dhe as nga mamaja e saj, pasi kjo pasuri është përfituar me anë të shkëmbimit të truallit. Subjekti shpjegon se ka përdorur si veprim juridik kontratën e shitjes, pasi kjo ishte mundësia e vetme që të realizohej kalimi i pronësisë në emrin e saj, situatë kjo e krijuar për shkak të vështirësive financiare të shoqërisë “{***}” ShPK.

Subjekti pretendon se nuk ka vepruar asnjëherë si pronare trualli, ndërkohë që shprehjen “*pronare e truallit*” të vendosur në kontratën e sipërmarrjes të firmosur prej saj dhe shoqërisë ndërtuese, konsideron si një lapsus të noteres, pasi ka qenë një kontratë tip e realizuar. Sipas subjektit, kalimi i pronësisë është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil duke plotësuar të gjitha detyrimet kundrejt shtetit.

Subjekti i rivlerësimit i konsideron si gabime materiale të bëra nga shoqëritë e ndërtimit mospërputhjet mes sipërfaqeve të kontratës dhe numrave të pasurive, gjë e cila nuk mund të penalizojë atë në lidhje me këto gabime të bëra nga të tretët dhe që vërtetohet se nuk ka pasur asnjë përfitim prej tyre.

25.3. Me qëllim verifikimin dhe sqarimin e problematikës së krijuar me këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim deklaratimet e subjektit, si dhe dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit, nga ku konstatoi se:

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri ka deklaruar: “*Apartament me sip. 123 m², ndodhur në {***}, Kavajë, pasuri me nr. {***}, z. k. {***}. Kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë. 26.11.2007, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë. 13.01.2004 dhe kontratë së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 30.10.2004. Burimi i krijimit: përfituar nga mamaja L. V. si ish-pronare trualli. Vlera 4.500.000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë, 100% në pronësi”.*

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Apartament me sip. 123 m², ndodhur në {***} Kavajë, dhënë nga mamaja L. V. si pronare truall, kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2007, në vlerën 4.500.000 (katër milion e pesëqind mijë) lekë, 100% në pronësi”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nëna e subjektit, znj. L. V. ka qenë pronare e truallit me sipërfaqe prej 600 m², të ndodhur në {***}, Kavajë. Me cilësinë e një prej bashkëpronarëve të truallit ajo ka lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 13.01.2004, me shoqërinë *“{***}” ShPK*. Referuar kësaj kontrate të gjithë bashkëpronarët, në këmbim të truallit të dhënë për ndërtim investitorëve, do të përfitonin 26 % të sipërfaqes totale të ndërtimit.

Me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 30.10.2004, shoqëria *“{***}” ShPK* ka pranuar që në këmbim të truallit të dhënë nga znj. L. V. (H.), ajo do të përfitonte:

- apartament 1+1 dhe ambient të tjera ndihmëse me sipërfaqe ndërtimore 81,5 m², ndodhur në {***}, ap. {***}, kati {***}; apartament 1+1 dhe ambient të tjera ndihmëse me sipërfaqe ndërtimore 81,5 m², ndodhur në {***}, ap. {***}, kati {***}. Në të njëjtën datë 30.10.2004, shoqëria *“{***}” ShPK* ka nënshkruar me subjektin e rivlerësimit kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., sipas së cilës i ka vënë në dispozicion kësaj shoqërie truallin, për ndërtimin e një godine banimi shumëkatëshe, në përfundim të së cilës subjekti i rivlerësimit do të përfitonte një apartament 2+1 dhe ambiente të tjera ndihmëse me sipërfaqe ndërtimore 118,5 m², ndodhur në {***}, ap. {***}, kati {***}.

25.4. Sipas ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.02.2020, i ka përcjellë Komisionit dokumentacionin mbi pasuritë e regjistruara në pronësi të Rezarta Balliut dhe znj. L. V., nëna e subjektit të rivlerësimit. Nga verifikimi i tij rezulton se në emër të subjektit të rivlerësimit Rezarta Balliu është e regjistruar pasuria apartament me sip. 123 m², me nr. {***}, z. k. {***}, vol. {***}, fq. {***}, objekt analize.

Bashkëlidhur ndodhet kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2007. Në këtë kontratë përfaqësuesi i shoqërisë *“{***}” ShPK* rezulton se i ka shitur subjektit Rezarta Balliu apartamentin, me sipërfaqe totale 123 m², nr. {***}, në çmimin 4.500.000 lekë, sipas kontratës shuma është likuiduar nga znj. L. V., nëna e blerëses⁴³. Gjithashtu, ndodhet kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2007, ku përfaqësuesi i shoqërisë *“{***}” ShPK* i ka shitur znj. L. V. (nënës së subjektit), një apartament me sipërfaqe 79,1 m², me çmim 2.900.000 lekë. Ndërsa kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.01.2009, ku përfaqësuesi i shoqërisë *“{***}” ShPK* i ka shitur znj. L. V. (nënës së subjektit), një apartament me sipërfaqe 80 m², me çmim 3.416.000 lekë⁴⁴.

⁴³Në këtë kontratë shitblerje është pasqyruar ky fakt mbasi është cilësuar: *“Kjo kontratë shitje realizohet për arsye se nëna e subjektit është me cilësinë e pronares së truallit mbi të cilën është ndërtuar apartamenti objekt i kësaj kontrate, për arsye të mospërputhjes së pozicionit të truallit të blerëses me godinën e ndërtuar nga shoqëria ‘{***}’ ShPK (shitësi)”*.

⁴⁴Gjithashtu, referuar procesverbalit të rakordimit të datës 18.11.2011, mbajtur ndërmjet shoqërisë *“{***}” ShPK* dhe znj. L. V., të depozituar nga subjekti⁴⁴, akt i depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit II, të datës 17.02.2020, rezulton se asnjë nga pasuritë e përfituara nga nëna e subjektit nuk përputhet me numrin e pasurisë në pronësi të subjektit nr. {***}, z. k. {***}, vol. {***}, fq. {***}, deklaruar si e përfituar nga nëna për shkak të shkëmbimit të truallit me ndërtimin.

25.5. Lidhur me arsyet e hartimit të këtyre kontratave dhe mënyrën e likuidimit të shumave të përcaktuar në to, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.07.2019, të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë “{***}” ShPK, z. J. K.⁴⁵, i cili ka deklaruar se *pavarësisht se në kontratë është vendosur çmimi prej 2.900.000 lekësh dhe prej 3.416.000 lekësh për L. V. (H.) dhe vlera prej 4.500.000 lekësh për Rezarta Balliu (Vigani), këto vlera nuk janë paguar as nga L. V. (H.) dhe as nga Rezarta Balliu (Vigani), për arsye se janë përfituar si pronarë truall, në bazë të kontratave të sipërmarrjes së cituara më lart. Në deklaratën noteriale, datë 05.02.2009, nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. L. V., ka deklaruar heqjen dorë nga pronësia, meqenëse sipërfaqen ndërtimore, sipas marrëveshjes që kishte me shoqërinë “{***}” ShPK, e ka marrë nga shoqëria “{***}” ShPK⁴⁶.*

25.6. Në kontratën që shoqëria “{***}” ShPK ka lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK në datën 20.12.2004, palët kanë rënë dakord që nënsipërmarrësi “{***}” ShPK [...] merr përsipër të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kontrata që sipërmarrësi ka bërë me pronarët e truallit, qoftë si shifër 26% të sipërfaqes së ndërtimit, qoftë edhe për zgjedhjen faktike të apartamenteve në të dy korpuset [...]. Nga ky parashikim kontraktor rezulton qartë, jo vetëm që shoqëria “{***}” ShPK ka ruajtur të drejta dhe detyrime të njëjta kundrejt pronarëve si shoqëria e parë, por edhe që marrëdhënia me pronarët e truallit është marrë përsipër të finalizohet me kontratën e shkëmbimit dhe jo me kontrata fiktive shitjeje.

25.7. Sikurse konstatohet më lart, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 30.10.2004, me qëllim përfitimin e një apartamenti, duke e shkëmbyer me truallin, i cili nuk ishte në pronësi të saj. Trupi gjykues vlerëson se kjo kontratë e hartuar para noterit nuk mund të konsiderohet lapsus, sikundër pretendon subjekti i rivlerësimit, pasi palët kanë shprehur vullnetin e tyre për të kryer një veprim juridik për një të drejtë që nuk ekzistonte (pronësia mbi truallin e subjektit), duke krijuar në këtë mënyrë një veprim juridik fiktiv në kundërshtim me dispozitat ligjore të Kodit Civil.

25.8. Në përfundim të analizimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 123 m², ndodhur në Kavajë, Kolegji vëren se konkluzioni i Komisionit në vendimin objekt ankimi është i ndryshëm nga ai i marrë nga Komisioni e Kolegji për subjektin e rivlerësimit A. B., ndonëse në të njëjtat rrethana faktike dhe ligjore, në këto kushte, pavarësisht qëndrimit të Kolegjit se personi i lidhur e subjekti i rivlerësimit ishin në kushtet e nenit 33/5 germat “a” dhe “b” për këtë pasuri, e gjen të panevojshëm të shprehet lidhur me këtë shkak ankimi ndaj vendimit objekt shqyrtimi dhe e gjen këtë qëndrim pa peshë në kontrollin e këtij vendimi

⁴⁵Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK, z. J. K. ka deklaruar se [...] Pas përfundimit të punimeve dhe regjistrimit të objektit në hipotekë shoqëria “{***}” ShPK i ka kaluar në pronësi apartamentet, znj. Rezarta Balliu (Vigani) dhe znj. L. V. (H.) nëpërmjet kontratave të shitjes për shkak se prona, sipas kontratës së sipërmarrjes ndodhet në {***} që u ndërtua nga shoqëria {***} ShPK, kurse pronat që do të përfitonin ishin në {***}, pra, nuk përputhej prona sipas kontratës së sipërmarrjes me pronën që do të përfitohej sipas kësaj kontrate. Pronarëve të truallit që e kishin pronën në {***} ju bë kontratë shkëmbimi ndërsa pronarëve të tjerë iu bë kontratë shitblerje, pasi nuk kishte mënyrë tjetër për të realizuar kalimin e pronësisë.

⁴⁶Ndër të tjera, në këtë deklaratë, duke referuar kontratën e sipërmarrjes të datës 13.01.2004, ka deklaruar se nga ndërtimi do të përfitoja [...] 26% të sipërfaqes ndërtimore, dhe nga ky 26% unë kam përfituar, sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., datë 30.10.2004, dy apartamente banimi me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore 163 metër katror [...].

Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendimi nr. 418, datë 09.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Rezarta Balliu nga detyra, është i mbështetur në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 418, datë 09.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Rezarta Balliu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.09.2023.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi